



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e Analizave Politike 2012/04

Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike

Prishtinë, qershor 2012

Ky projekt është përkrahur me zemërgjerësi nga: Departamenti Federal i Punëve të Jashtme (FDFA) i Zvicrës



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të KIPRED dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e donatorit.

Përgatitur nga: Albert Krasniqi & Krenar Shala

Redaktuar nga: Ardian Arifaj

E drejta autoriale © 2012 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni info@kipred.org apo +381 38 227 778.

Publikuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778
www.kipred.org

PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	4
1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
1.2 Metodologjia.....	6
2. konteksti.....	8
2.1 Roli i partive politike në zhvillimin e demokracisë.....	8
2.2 Tradita demokratike në Kosovë.....	8
2.3. Demokracia brenda partive politike.....	9
2.3 Si funksionojnë partitë përbrenda.....	11
2.4 Korniza ligjore.....	13
2.5 Zyra për Regjistrimin e partive politike e KQZ.....	13
2.6 Statutet e Partive politike.....	15
2.7 Një rol më i madh për Zyrën për regjistrimin e partive politike të KQZ.....	16
3. Praktikrat në partitë politike.....	18
3.1 Partia Demokratike e Kosovës – PDK.....	18
3.2 Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK.....	20
3.3 “Lëvizja VETËVENDOSJE!” – LVV.....	24
3.4 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK.....	26
3.5 Aleanca Kosova e Re – AKR.....	29
3.6 Koalicioni VAKAT.....	30
3.7 Partia e Pavarur Liberale – SLS.....	31
3.8 Partia Demokratike Turke e Kosovës – KDTP.....	32
4. Konkluzione dhe rekomandime.....	35
4.1 Nevoja për reformim.....	35
4.2 Rekomandimet.....	36

SHKURTESAT

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
BSK	Bošnjačka Stranka Kosova (Partia Boshnjake e Kosovës)
DSB	Demokratska Stranka Bošnjaka (Partia Demokratike Boshnjake)
DSV	Demokratska Stranka Vatan (Partia Demokratike Vatan)
KDTP	Partia Demokratike Turke e Kosovës
KKR	Koalicioni për Kosovën e Re
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NDS	Nova Demokratska Stranka (Partia Demokratike e Re).
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
SLS	Samostalna Liberalna Stranka (Partia e Pavarur Liberale)
SHIK	Shërbimi Informativ i Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VAKAT	Koalicioni VAKAT
VV	“Lëvizja VETËVENDOSJE!”
Zyra	Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Partitë politike luajnë një rol thelbësor në procesin e zhvillimit të demokracisë . Ato janë një urë lidhëse në mes të shoqërisë dhe politikës. Duke e marrë për bazë këtë fakt, atëherë është e nevojshme që partitë politike të kenë demokraci të brendshme ashtu që shqetësimet dhe preferencat e shoqërisë të gjejnë vend në debatin dhe agjendat e tyre. Rrjedhimisht zhvillimi i proceseve demokratike në një shoqëri është i lidhur ngushtë me demokracinë e brendshme në partitë politike.

Demokracia, si pluralizëm i alternativave politike, është përvojë e re për Kosovën. Ndonëse sistemi shumë-partiak është instaluar në të njëjtën kohë kur pluralizmi politik është përhapur në tërë Evropën Jug-Lindore, kushtet e represionit nën të cilin gjendej Kosova qysh prej heqjes së autonomisë së saj nga Serbia, më 1989, nuk lejuan hapësirë për jetë të mirëfilltë politike pluraliste e demokratike.

Partitë politike në Kosovë i plotësojnë kushtet e definicionit themelor sociologjik të asaj se çfarë është një parti politike – një grup i organizuar që kërkon të marrë pushtetin me mjete politike. Por jo edhe kritere tjera. Nuk është gjë e re të përsëritet se partitë politike në Kosovë nuk kanë ideologji politike të tyre, nuk kanë programe të mirëfillta, madje nuk kanë as anëtarësi të qartë. Tregues më i mirë i mungesës së ideologjisë dhe përkatësisë dhe identifikimit të anëtarëve me ideologjinë e partisë është kalimi i shpeshtë i anëtarëve të një partie politike te tjetra. Pothuajse nuk ka parti politike në Kosovë që nuk ka humbur anëtarë e madje edhe zyrtarë të lartë të cilët kanë kaluar në një parti tjetër, sikur që gati se nuk ka parti që nuk ka marrë anëtarë dhe zyrtarë të një partie tjetër.

Format joformale të vendimmarrjes janë të shpeshta dhe të fuqishme. Lideri dhe njerëzit e afërt me të ushtrojnë më tepër fuqi se sa u përcaktohet me statut. Vendime të rëndësishme për partinë merren në takime joformale, në dreka apo ndeja. Këto forma joformale të vendimmarrjes shpesh paraqiten si mënyra kryesore e marrjes së vendimeve më të rëndësishme për partinë, duke i vënë në hije të gjitha organet e partisë dhe kërkesat e dala nga dokumentet themelore të partisë. Ajo që është më shqetësuese është se të gjitha këto vendime të marra në mënyrë joformale organet e partisë më pas i formalizojnë ashtu që “të kënaqet ligji”.

Korniza ligjore për funksionimin e partive politike në Kosovë është krijuar pas luftës së vitit 1999 dhe duke marrë parasysh praktikat më të mira të kohës. Megjithatë, korniza aktuale nuk është zhvilluar me të njëjtën dinamikë sikur shoqëria dhe nevojat e saj. Regjistrimi dhe certifikimi i partive politike ende bëhet në bazë të një rregulloreje e jo ligji. Mekanizmat që garantojnë respektimin e legjislacionit për funksionimin e partive politike nuk janë fuqizuar asnjëherë aq sa të jetë në gjendje që të monitorojë me efikasitet veprimtarinë e partive politike dhe të sanksionojnë partitë kur shkelin legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, kjo ka inkurajuar praktikat jodemokratike brenda partive politike.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike që vepron në kuadër të KQZ-së ka dështuar të luajë rolin që duhet të ketë. Kjo ka ndikuar negativisht edhe te partitë politike pasi ato nuk janë ndier të obliguara që t’u përmbahen kërkesave ligjore. Ky studim zbulon se shkak kryesor që

kjo Zyre nuk arin të përmbushë detyrën ashtu siç duhet është mungesa e kapaciteteve pasi Zyra nuk ka personel të mjaftueshëm. Gjithashtu, dyshohet se ka edhe mungesë të integritetit profesional të stafit të zyrës që di të lakohet para presioneve të politikës.

Ky punim, ofron edhe një analizë të detajuar rreth praktikave në partitë politike në Kosovë. Është parë funksionimi i brendshëm i parive politike, duke analizuar statutin dhe institucionet partiake, rolin e liderit, format joformale të vendimmarrjes si dhe forcën kohezive brenda partive. Partitë e përfshira në këtë studim janë: PDK, LDK, “Lëvizja VETËVENDOSJE!”, AAK, AKR, SLS, Koalicioni VAKAT si dhe KDTP.

Shumica e partive politike të intervistuar për këtë punim shprehen të vetëdijshme për nevojën për reformim të brendshëm dhe kanë ndërmarrë hapat inicialë për të filluar reformat. Për më tepër, partitë kanë kuptuar se duhet vërtetë të angazhohen për të fituar votën e elektoratit, të vetëdijshme se aspiratat e deklaruara edhe të partive politike, që Kosovën ta shpijnë në Bashkimin Evropian, nuk do të tolerojnë zgjedhje të manipuluar dhe vjedhje të votës “në shkallë industriale” çfarë është parë deri tani.

1.2 Metodologjia

Për qëllimet e këtij raporti, KIPRED ka përdorur metodologji kualitative, duke u bazuar në hulumtimet në zyrë dhe në intervista individuale.

Fillimisht është bërë një analizë e kornizës ligjore që rregullon veprimin e partive politike, duke u përqendruar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale, Ligjin për Financimin e Partive Politike, Rregulloren e KQZ-së për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Kodin e Mirësjelljes për Subjekte Politike si dhe Rregulloren mbi Sanksionet dhe Gjrobat. Pastaj janë analizuar të gjitha statutet dhe programet e partive politike që kanë qenë pjesë e studimit tonë¹, me fokus në kompetencat e organeve ekzekutive, mënyrën e zgjedhjes së tyre dhe obligimet e raportimit. Qasja e analizës ka qenë fillimisht e veçantë, ku secila parti është studiuar veçanërisht, ndërsa më pas janë studiuar çështjet e ngjashme dhe fenomenet negative të spikatura në këto parti.

Me të përfunduar analiza e kornizës ligjore, statuteve dhe programeve të subjekteve politike, KIPRED ka zhvilluar intervista të detajuara me liderët, përfaqësues dhe anëtarë të subjekteve politike për t'i përcaktuar të arriturat por edhe sfidat kryesore me të cilat përballen ato. Krahas intervistave me përfaqësues politik, KIPRED ka zhvilluar edhe një cikël të intervistave me ekspertë të pavarur dhe përfaqësues të mediave për të marr vlerësime sa më objektive rreth gjendjes së brendshme në partitë politike në Kosovë.

Nga këto analiza rezulton raporti i mëposhtëm që në fakt është vetëm një fotografi çasti e gjendjes në partitë politike. Ky studim ka dëshmuar se – pasi partitë politike në Kosovë janë në zhvillim e sipër – për të pasur një vlerësim adekuat dhe përherë të azhurnuar është i nevojshëm një monitorim i përhershëm dhe gjithëpërfshirës i punës së partive politike në

¹ Studimi ka përfshirë tetë parti politike: PDK, LDK, “Lëvizja VETËVENDOSJE!”, AAK, AKR, SLS, Koalicioni VAKAT si dhe KDTP.

Kosovë. Kjo nënkupton monitorimin e zgjedhjeve në parti në të gjitha nivelet për të identifikuar të arriturat apo mangësitë; pastaj përcjellja e procesit të vendim-marrjes në afat më të gjatë dhe në të gjitha rrethanat, për të parë nëse demokracia brenda partisë funksionon tërë kohën; si dhe të përcjellët raportimi i brendshëm dhe ndikimi i këtij raportimi në funksionimin e partisë. KIPRED synon të realizojë edhe një studim të tillë në të ardhmen.

2. KONTEKSTI

2.1 Roli i partive politike në zhvillimin e demokracisë

Partitë politike ruajnë një rol thelbësor në procesin e zhvillimit të demokracisë. Ato janë një urë lidhëse në mes të shoqërisë dhe politikës. Teoricienët argumentojnë që roli i partive politike, për shkak të rëndësisë që ka relacioni shoqëri-politikë, konsiderohet si e mirë esenciale publike për demokracinë.

Për këtë arsye, fuqizimi dhe ngritja në vazhdimësi e kredibilitetit të partive politike karshi interesave të qytetarëve është imperativ për një demokraci funksionale. Në këtë mënyrë, fuqizimi dhe qëndrueshmëria e partive politike automatikisht reflektohet në dinamizimin e demokracisë dhe ruajtjen e kohezionit të një shoqërie, si kusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomiko-social. Partitë politike duhet të jenë të afta që të përfaqësojnë denjësisht interesat e qytetarëve si dhe të formulojnë politika publike që mund të demonstrojnë aftësinë e tyre për administruar me të mirën publike pasi që të fitojnë legjitimitetin demokratik.²

Partitë politike kryejnë disa funksione qenësore në shoqëritë demokratike, e rrjedhimisht rol të tillë pritët të luajnë edhe në shoqërinë kosovare. *Funksioni i parë* është hartimi i programeve dhe vizioneve të tyre politike. Bazuar edhe në ideologjinë që një parti politike mund ta ndjekë, këto duhet të jenë domosdoshmërisht të ndryshme apo më kreative në kuptimin e programeve politike dhe kandidatëve në mënyrë që të jenë më atraktive për votuesit. *Funksioni i dytë* është marrja në konsideratë e kërkesave politike, ekonomike dhe sociale të shoqërisë. Në këtë rast, kërkesat mund të jenë nga më të ndryshmet dhe nganjëherë mund të jenë në konflikt me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, roli i partive politike është që t'i diskutojnë dhe vlerësojnë çështjet me rëndësi për shoqërinë apo një grup shoqëror dhe t'i shndërrojnë nevojat dhe kërkesat e publikut në politika alternative. *Funksioni i tretë*: partitë politike janë motori kryesor i rekrutimit të individëve në postet publike, përkatësisht në nivelin ekzekutiv dhe atë legjislativ. Dhe *Funksioni e katërt* i partive politike është mbikëqyrja ose kontrolli i qeverisë varësisht se në çfarë pozicioni politik janë: në pushtet apo në opozitë.³

2.2 Tradita demokratike në Kosovë

Demokracia, si pluralizëm i alternativave politike, është përvojë e re për Kosovën. Ndonëse sistemi shumë-partiak është instaluar në të njëjtën kohë kur pluralizmi politik është përhapur në tërë Evropën Jug-Lindore, kushtet e represionit nën të cilin gjendej Kosova qysh prej heqjes së autonomisë së saj nga Serbia, më 1989, nuk lejuan hapësirë për jetë të mirëfilltë politike pluraliste e demokratike. Ndonëse gjatë viteve 1990 në Kosovë vepronin më shumë se një parti politike – Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Social-Demokrate e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demo-Kristiane e Partia Liberale janë disa nga partitë

² NDI - Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspectives, Pippa Noris, fq. 1

³ http://www.idea.int/parties/international_assistance/parties_necessary.cfm

që ekzistonin para luftës – megjithatë këto nuk operonin në një ambient që lejonte zhvillim normal të jetës politike dhe demokracisë.

Pas përfundimit të luftës u krijua hapësirë e re për veprim politik dhe partiak. Shumë nga partitë e vjetra vazhduan të operonin ndërsa u themeluan edhe parti të reja. Në hapësirën e re të krijuar këto parti filluan të bëjnë garë politike dhe të kërkojnë votën e qytetarit, duke shënuar një hap të madh përpara në instalimin e praktikës demokratike në Kosovë. Vetëm pas luftës në Kosovë filloi të ndjehet tranzicioni i mirëfilltë politik nga sistemi një partiak në sistem pluralist. Ishte ky një tranzicion i vonuar më shumë se një dekadë.

Më shumë se një dekadë tjetër pas përfundimit të luftës, mbetet ende shumë për t'u bërë në konsolidimin e praktikave demokratike në jetën politike në Kosovë, përfshirë edhe partitë politike. Pengesë kryesore e këtij procesi ka qenë faza emergjente e rindërtimit ekonomik e social në të cilin u gjet shoqëria kosovare pas luftës. Përballja me nevojën imediate për rindërtim fizik të vendbanimeve, plotësimi i nevojave emergjente për mbijetesë fizike – në ditët e para të pasluftës – si dhe konsolidimi i institucioneve vendore, pa pasur ende kohë për t'u përqendruar në zhvillim ekonomik dhe të politikave sociale në vitet pas fazës emergjente, kanë bërë që partitë politike të mos jenë në gjendje që të përpilojnë dhe garojnë me politika rreth çështjeve thelbësore. Konkretisht, deri sa Kosova nuk ka ekonomi të konsoliduar atëherë sigurisht që partitë nuk do të jenë në gjendje të artikulojnë politika të ndryshme për – për shembull – politikën tatimore, por do të mjaftohen duke thënë se do të sjellin zhvillim ekonomik. Thënë shkurt, vendi deri tani nuk ishte në pikën kur partitë politike e kanë imperativ profilizimin sipas ideologjive që promovojnë.

Më 17 shkurt 2008, Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse e shpallën Kosovën shtet të pavarur. Me këtë u hapën dyert për kalimin e të gjitha kompetencave shtetërore tek institucionet vendore⁴. Faza e pas-pavarësisë u karakterizua me ngritjen e institucioneve të tjera shtetërore që më parë nuk kishin ekzistuar apo kishin qenë të administruara nga misionet ndërkombëtare. Ky hap i konsolidimit demokratik e institucional njëkohësisht tash shfaqet edhe si sfidë e madhe për shoqërinë kosovare. Mund të pritët që me zhvillimin ekonomik dhe social do të fillojnë të artikulojnë edhe orientimet programore të partive politike e me këtë do të konsolidohet edhe skena politike në Kosovë.

2.3. Demokracia brenda partive politike

Duke e marrë për bazë faktin që partitë politike luajnë rolin e një ure lidhëse në mes të shoqërisë apo një grupi shoqëror dhe politikës, atëherë është e nevojshme që partitë politike të kenë demokraci të brendshme ashtu që shqetësimet dhe preferencat e shoqërisë të gjejnë vend në debatin dhe agjendat e tyre. Rrjedhimisht zhvillimi i proceseve demokratike në një shoqëri është i lidhur ngushtë me demokracinë e brendshme në partitë politike. Mbase, mund të konkludojmë lirshëm se është e pamundur që një shoqëri të jetë demokratike pa demokraci të brendshme në partitë politike. Megjithatë, shumica e studiuesve pajtohen me faktin që roli i partive politike, megjithëse thelbësor, nuk mund të jetë faktori i vetëm vendimtar në një

⁴ Përfundim bën siguria e jashtme, që mbetet kompetencë e forcës paqeruajtëse KFOR.

shoqëri demokratike. Medoemos, roli i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të lira duhet të konsiderohet si komplementar në zhvillimin demokratik të një shoqërie.

Për nevojat e këtij studimi, është me rëndësi të sqarohet se çfarë nënkuptohet me termin demokraci brenda partisë. Vetëm pasi të sqarohet kjo mund të matet niveli i demokracisë në parti. Më saktësisht, me demokraci të brendshme në një parti politike nënkuptojmë zgjedhjen e kandidatëve dhe liderëve në një garë të hapur dhe të drejtë, transparencën, inkluzivitetin e grupeve të ndryshme të shoqërisë gjatë formulimit të politikave dhe financimin transparent.

Për nevojat e këtij studimi është shikuar se sa respektohen dokumentet bazë të partisë si statuti; sa është e hapur gara për avancim në parti; sa është e shpeshtë dhe e fuqishme mënyra joformale e vendim-marrjes; cila është forca kohezive në parti; cilat janë sfidat me të cilat përballet partia dhe çfarë është kualiteti i raportimit, si mekanizëm për të kërkuar përgjegjësi nga udhëheqësit e partisë.

Për më tepër, zhvillimi i demokracisë brenda partive politike nuk mund të shihet si proces i shkëputur nga zhvillimet e përgjithshme shoqërore e ekonomike në Kosovë. Shoqëria kosovare ende është në një fazë emergjence, në krijim të themeleve të shtetit, pa ekonomi të mirëfilltë dhe në një tranzicion të shumëfishtë. Ndër tranzicionet e rëndësishme në këtë kontekst është tejkalimi i patriarkalizmit. Individit në shoqërinë kosovare shpesh rritet dhe pjekët në një ambient patriarkal, më saktësisht në një ambient në të cilin nuk inkurajohet mendimi i pavarur, individual, kritik e kreativ. Përkundrazi, individit i nënshtrohet vullnetit të kryefamiljarit. Një nënshtrim i tillë ndaj autoritetit dhe pritja që ky autoritet të tregojë se çfarë duhet bërë e madje edhe çfarë duhet besuar, përcjellët pastaj edhe në grupet sociale më të gjëra se sa familja. Prandaj, është e pritshme që një sjellje e tillë të haset edhe në partitë politike, pra anëtarët e partisë të presin nga lideri i partisë më tepër se sa duhet. Megjithatë, pasi në parti individit nuk pritët të tregojë të njëjtin lojalitet sikur në familje, kjo do të duhej të krijonte më tepër hapësirë për veprimtari të pavarur e madje edhe kontestim dhe garë në mes të anëtarëve të partisë. Pasi partitë politike kosovare ende nuk janë të profilizuara ideologjikisht, ashtu që gara të bëhet rreth ideve dhe politikave për implementim të ideologjisë, atëherë gara mes anëtarëve të partisë është bërë për motivin e thjeshtë të marrjes së pushtetit dhe të gëzimit të privilegjeve personale që mund të sjellë mbajtja e posteve të larta në një parti politike.

Ndonëse pajtohem që zhvillimi i mëtutjeshëm i partive politike në Kosovë nuk mund të shihet i ndarë nga zhvillimi i përgjithshëm i shoqërisë, kjo nuk shfaqëson partitë politike nga përgjegjësia që kanë ato në reformimin e shoqërisë. Përkundrazi, partitë politike janë përgjegjëset kryesore për reformimin e përgjithshëm të shoqërisë pasi me qasjen që kanë në pushtetin ekzekutiv dhe buxhet janë përgjegjëse për politikën dhe vendimet se kah do të shkojë shoqëria kosovare, përpara apo prapa.

Prandaj, zhvillimi i partisë, i praktikave demokratike brenda partisë, si dhe zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë për zhvillimin ekonomik e social të tërë shoqërisë duhet të jetë lartë në agjendat e partive politike në Kosovë.

2.3 Si funksionojnë partitë përbrenda

Partitë politike në Kosovë kanë marrë mbështetje të madhe nga institucione kombëtare e ndërkombëtare në shtimin e kapaciteteve administrative e politike. Është ofruar asistencë në përgatitjen e dokumenteve themelore të partisë siç janë statuti dhe programi politik apo rregulloret e tjera të organizmit të brendshëm të partisë me qëllim që partitë të zhvillohen mbi baza të shëndosha që do të garantojnë funksionim demokratik të partisë. Struktura e partive politike në Kosovë shpeshherë është reflektim i përvojave më të mira në organizimin dhe funksionimin e partive politike.

Partitë politike në Kosovë i plotësojnë kushtet e definicionit themelor sociologjik të asaj se çfarë është një parti politike – një grup i organizuar që kërkon të marrë pushtetin me mjete politike. Por mbeten pa u plotësuar edhe shumë kritere tjera. Nuk është gjë e re të përsëritet se partitë politike në Kosovë nuk kanë ideologji politike të tyre, nuk kanë programe të mirëfillta, madje nuk kanë as anëtarësi të qartë. Tregues më i mirë i mungesës së ideologjisë dhe përkatësisë dhe identifikimit të anëtarëve me ideologjinë e partisë është kalimi i shpesh të anëtarëve të një partie politike te tjetra. Pothuajse nuk ka parti politike në Kosovë që nuk ka humbur anëtarë e madje edhe zyrtarë të lartë të cilët kanë kaluar në një parti tjetër, sikur që gati se nuk ka parti që nuk ka marrë anëtarë dhe zyrtarë të një partie tjetër.

Motiv kryesor për anëtarësim në një parti politike dhe për të mbetur në të është marrja e pushtetit dhe gëzimi i përfitimeve që sjell pushteti. Në Kosovë, këto përfitime nënkuptojnë përfitime financiare jo vetëm në formë të pagës dhe mundësi për të kontribuar në politikat shtetërore, por edhe të mundësisë për të abuzuar me sistemin dhe duke përfituar financiarisht nga mbajtja në dorë e pushtetit; abuzimi me fuqinë e politikës për të bërë presion mbi shtyllën e gjyqësorit; dhe kënaqësi me statusin social më të lartë sidomos në sytë e bashkëqytetarëve.

Përfitimi financiar e material duket se është forca më e madhe kohezive brenda partisë politike, që i mban anëtarët në parti dhe i shtynë e motivon të angazhohen dhe të punojnë. Gara për poste motivohet nga dëshira për më shumë pushtet personal dhe përfitime personale. Kjo e bën edhe më të fuqishëm rolin e liderit të partisë pasi “shpërblimi” me poste partiake si dhe me pushtet shihet si përfitimi më i mirë. Kjo garë, me këto motive, kërcënon edhe substancën e partisë dhe proceset demokratike brenda partisë. Kjo ka inkurajuar vendimmarrjen jo-formale dhe krijimin e grupeve dhe fraksioneve joparimore brenda partive.

Hapja e listave të votuesve e ka bërë këtë garë mes kolegëve në parti edhe më të paskrupullt. Paradokalisht, kjo po i shtynë partitë drejt zbehjes së bashkëpunimit të brendshëm deri në skajshmëri duke rrezikuar substancën e vet partisë. Kjo i ka detyruar partitë që të fillojnë të mendojnë për korrigjim të praktikave të brendshme dhe për reformim. Listat e hapura e kanë zbehur edhe rolin e liderit – që ishte një nga synimet kryesore të idesë për aplikimin e listave të hapura – dhe e ka bërë më të hapur garën brenda partisë. Pranimi se partia duhet të reformohet dhe të kthehet në parti politike të mirëfilltë, në definicionin e plotë sociologjik të partisë politike, si dhe zbehja e rolit të liderit të partisë, duket se po i detyron partitë që të mendojnë seriozisht për ndryshime pozitive përbrenda.

Shumica e partive të studiuara në këtë raport kanë ndryshuar apo janë në proces të ndryshimit të statutit të partisë. PDK është në fazën e ndryshimit të statutit; LDK ka miratuar statutin e ri në mars të vitit 2012; Lëvizja VETËVENDOSJE! vazhdimisht e plotëson statutin. Edhe partitë tjera kanë statute të reja të miratuara në vitet e fundit. Nga studimet e statuteve, del se ai i LVV është më i avancuari nëse merret për bazë kufizimi i mandateve si dhe aplikimi i demokracisë së drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve të rëndësishme. Por, edhe statutet tjera nuk janë prapa. Problem nuk është ana formale e funksionimit të partive. Problem është preferenca që të anashkalohen kërkesat e statutit dhe të shfrytëzohen rrugët joformale të vendimmarrjes.

Format joformale të vendimmarrjes janë të shpeshta dhe të fuqishme. Lideri dhe njerëzit e afërt me të ushtrojnë më tepër fuqi se sa u përcaktohet me statut. Jo rrallë vendime të rëndësishme për partinë merren në takime joformale, në dreka apo ndeja. Shembulli më drastik është ai i njohur në opinion si “Rasti Zanzibar” kur PDK vendos të shkëpusë marrëveshjen e koalicionit qeverisës gjatë një diskutimi në një bar në Prishtinë; kur VETËVENDOSJE dhe FER vendosin të bashkohen në bazë të diskutimeve në baret e Prishtinës, duke anashkaluar organet e partisë dhe procedurat që kërkojnë statutet e këtyre subjekteve; KDTP e ka miratuar statutin e ri në një darkë/iftar në të cilin janë ftuar vetëm delegatët që ishin të afërt me kryetarin. Këto forma joformale të vendimmarrjes shpesh paraqiten si mënyra kryesore e marrjes së vendimeve më të rëndësishme për partinë, duke i vënë në hije të gjitha organet e partisë dhe kërkesat e dala nga dokumentet themelore të partisë. Kjo praktikë nuk duket se është duke u zbehur. Partitë politike, të intervistuar nga KIPRED, kanë pranuar se edhe në zgjedhjen e kandidatëve për garat për Kryetar Komune në Ferizaj dhe në Kaçanik kanë përdorur rrugët joformale dhe ato në kundërshtim me statutin për të gjetur kandidatin. PDK, për shembull, pasi ka identifikuar kandidaten e preferuar nga qendra, e ka angazhuar degën që të procedojë dhe të nominojë kandidatin me rrugët formale. Ajo që është më shqetësuese është se të gjitha këto vendime të marra në mënyrë joformale organet e partisë më pas i formalizojnë ashtu që “të kënaqet ligji”.

Ekzistimi i rrugëve joformale të vendimmarrjes e bën të pushtetshëm dhe me rol qendror liderin e partisë dhe anasjelltas. Lideri, duke pasur fuqi që të ndikojë mbi zyrtarët e partisë, është në gjendje që të ndikojë në vendimet e tyre. Lidhjet e formuara mes liderit dhe zyrtarëve të partisë të preferuar nga lideri bëhen më të fuqishme dhe bëhen “forumi” kryesor ku merren vendime për partinë. Për anëtarët e partisë anëtarësimi në këtë “forum” bëhet synim kryesor. Shqetësues është edhe fakti se nëpërmjet ndikimit mbi liderët e partive, protagonistët ndërkombëtarë në Kosovë janë në gjendje të ndikojnë në vendimet e partisë, duke e inkurajuar vendimmarrjen joformale duke cenuar demokracinë brenda partive. Shembulli më drastik për këtë është ai i zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, kur kryetarët e tri partive politike i bindin grupet parlamentare respektive të votojnë për një kandidat që shumë prej tyre nuk e kanë njohur.

2.4 Korniza ligjore

Korniza ligjore për funksionimin e partive politike në Kosovë është krijuar pas luftës së vitit 1999 dhe duke marrë parasysh praktikat më të mira të kohës. Megjithatë, korniza aktuale nuk është zhvilluar me të njëjtën dinamikë sikur shoqëria dhe nevojat e saj. Regjistrimi dhe certifikimi i partive politike ende bëhet në bazë të një rregulloreje e jo në bazë të një ligji adekuat. Mekanizmat që garantojnë respektimin e legjislacionit për funksionimin e partive politike nuk janë fuqizuar asnjëherë aq sa të jenë në gjendje që të monitorojë me efikasitet veprimtarinë e partive politike dhe të sanksionojnë partitë kur këto shkelin legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, kjo ka inkurajuar praktikat jodemokratike brenda partive politike. Ndër këto praktika janë shkeljet e dispozitave të rregulloreve në fuqi si dhe praktika e marrjes së vendimeve nëpërmjet rrugëve joformale si dhe raportimi joadekuat e rrjedhimisht edhe jo-transparenca në punën e partive. Ndër ndryshimet e bëra për të inkurajuar demokratizimin e brendshëm të partive politike si dhe zbehjen e rolit të liderit në parti ishte zbatimi i praktikës së listave të hapura në zgjedhje. Ky ndryshim ka hyrë në fuqi në zgjedhjet e vitit 2007. Megjithatë, në vend se të rrisë demokracinë brenda partive politike, ky ndryshim ka dobësuar edhe më shumë partitë përbrenda. Tani, përnjëherë, kolegët në parti u bënë konkurrentë të drejtpërdrejtë të njëri tjetrit. Gara për vota nuk bëhej më vetëm me konkurruesit nga partitë tjera por edhe me bashkë-partiakët. Gara u bë e dyfishtë, jo vetëm për të bindur votuesin për të votuar për partinë tënde por edhe për të votuar ty e jo kolegët tjerë nga partia. Kjo e ka dobësuar edhe më tepër kohezionin edhe ashtu të brishtë në parti. Për më tepër, ky u bë edhe burim kryesor i manipulimit dhe vjedhjes së votës, sidomos në zgjedhjet e vitit 2010. Kuvendi i Kosovës ka themeluar një Komision Parlamentar ad-hoc për të korrigjuar Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë me qëllim që të adresojë këto lëshime. Komisioni nuk ka arritur të përmbyllë punën e vet brenda afatit që i është caktuar, kryesisht për shkak se partitë politike ende nuk janë dakorduar rreth ndryshimeve të rëndësishme siç është ndarja e Kosovës në zona elektorale apo listat e hapura, ndryshime këto që mund të prekin drejtpërdrejt substancën e partive si dhe demokracinë brenda tyre.

Financimi i partive politike duhet të bëhet më transparent dhe të implementohet në tërësi Ligji për Financimin e Partive Politike. Partitë nuk janë të sigërtë në raportimet e tyre financiare. Kjo bëhet e evidente në kohë të zgjedhjeve kur partitë disponojnë dhe shpenzojnë më shumë mjete financiare se sa që deklarativisht disponojnë. Auditimi i partive duhet të bëhet nga kompani të pavarura që të sigurohet transparencë e plotë para opinionit publik.

2.5 Zyra për Regjistrimin e partive politike e KQZ

Partitë politike në Kosovë regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme⁵ si dhe atij për Zgjedhjet Lokale⁶ në Republikën e Kosovës, KQZ ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (Zyra)⁷.

⁵ Ligji nr. 03/L-073, nenet 12.3, 64.2 (a) dhe (b)

⁶ Ligji nr. 03/L-072, nenet 13 dhe 20

⁷ Ligji nr. 03/L-073, neni 11.1

Kjo zyrë vepron në kuadër të KQZ-së dhe është përgjegjëse për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike si dhe certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim⁸.

Sipas ligjit në fuqi, KQZ ka nxjerrë rregullore të veçantë për regjistrimin e partive politike⁹ e cila përcakton procedurat për regjistrim dhe obligimet për raportim të partive politike. Procedurat për regjistrim kërkojnë që partitë politike të dorëzojnë kërkesën për aplikim, simbolin e partisë, të dhënat e përfaqësuesve të partisë, dokumentin e themelimit, së paku 500 nënshkrime të votuesve të regjistruar, statutin e partisë i cili duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat ligjore¹⁰, programin politik, deklaratën e fundit financiare, nënshkrimin e deklaratës për respektimin e Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike¹¹ si dhe të bëjnë pagesën e taksës për regjistrim prej 500 Euro. Pas aplikimit, Zyra shqyrton kërkesat dhe në afat prej tridhjetë ditësh njofton KQZ-në për statusin e aplikimit. Nëse dokumentacioni konsiderohet i kompletuar, KQZ shpall njoftimin në gazeta si dhe në faqen zyrtare në internet të KQZ-së brenda shtatë ditëve. Secili subjekt politik e ka të drejtën për të kundërshtuar kërkesën në bazë të arsyeve të paraqitura me shkrim në këtë Zyrë. Nëse ka kundërshtime, ato shqyrtohen dhe merret vendim për refuzim apo miratim të kërkesës. Në rast të refuzimit, njoftohen partitë me shkrim për arsyet e refuzimit. Brenda njëzet e katër orëve të ardhshme partitë mund të ushtrojnë ankesë në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, kurse apeli duhet të vendoset brenda shtatëdhjetë e dy orëve pasi të jetë shpallur¹². Nëse nuk ka kundërshtime, atëherë konstatohet se nuk ka arsye për refuzim dhe Zyra brenda tre ditëve i rekomandon KQZ-së regjistrimin e partisë politike.

Pas regjistrimit, partia është e obliguar të mbajë Kuvendin brenda gjashtë muajve nga data e regjistrimit, pastaj së paku çdo 42 muaj. Kuvendi obligohet të zgjedhë kryetarin e partisë dhe organin më të lartë ekzekutiv. Punimet e Kuvendit vëzhgohen nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim¹³.

Partitë Politike përveç që janë të obliguara të njoftojnë Zyrën për çdo ndryshim në organizimin e saj të brendshëm, ato duhet të dorëzojnë një herë në vit të dhënat e përmbledhura vjetore. Aktualisht me rregulloren në fuqi Nr. 01/2008, partitë deri me 1 mars obligohen të dorëzojnë raportin vjetor financiar. Ky raport është mjaft i detajuar dhe ndër të tjera kërkon edhe informata rreth bilancit bankar për çdo llogari në emër të saj, regjistrin e të gjitha kontributeve si dhe faturat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë vlerën prej njëqind euro¹⁴. Për më tepër, partia është e obliguar të mbajë evidencë të saktë dhe të hollësishme për shënimet financiare për një periudhë shtatëvjeçare.¹⁵ Raportet financiare kontrollohen nga Zyra në përputhje me standardet e kontabilitetit - të zbatueshme në Kosovë. Në rast të mos-

⁸ Shih rregulloren e KQZ-së nr 01/2008, neni 2.1

⁹ Rregullore e KQZ-së Nr. 01/2008

¹⁰ Shih rregulloren e KQZ-së nr 01/2008, neni 12

¹¹ Rregullore e KQZ-së Nr. 11/2009 Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatëve http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/legjisllacioni/materiale/rregullatkqz/11-2009_al.pdf (qasur me 17 maj 2012)

¹² Po aty, neni 8

¹³ Po aty, neni 13

¹⁴ Shih rregulloren e KQZ-së Nr 01/2008, neni 20

¹⁵ Po aty, neni 21

përbushjes së këtyre obligimeve ligjore për raportim, KQZ-ja sipas rekomandimit të Zyrës gjyqësore politike për vonesën e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar dhe i kategorizon sipas kriterit të përfaqësimit dhe afateve¹⁶. Gjyqësorja më e ulët e paraparë është 200 Euro për mbajtjen jo të rregullt të shënimeve në librin e kontabilitetit, kurse ajo më e larta është 2,000 Euro për fshehje ose falsifikim të shumës që është ndërmjet 3/4 deri 4/4 të kategorisë përkatëse. Gjyqësorja e mbledhura derdhen në Buxhetin e shtetit.

2.6 Statutet e Partive politike

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 12 që rregullon procedurat që duhet të ndiqen nga organet kompetente, në këtë rast Zyra për Regjistrimin e Partive Politike pranë KQZ-së, Neni 12, Paragrafi 12.3, Pika f përpos tjerash, kërkon që partitë politike që mëtojnë të regjistrohet pranë kësaj zyre, duhet të kenë statutet e tyre si dokumente që për nga natyra e definicionit legal njihen si dokumente ligjore obligative për organizimin e brendshëm partiak.¹⁷

Ndërkaq, sipas Rregullores që del nga Ligji Nr. 03/L-073 për Regjistrimin e Partive politike, përkatësisht neni 12, që përfshinë kornizën se si dhe çka duhet të përfshijë statuti i një partie politike, thuhet qartë që statutet e partive politike duhet të përfshijnë:

- (a) procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
- (b) procedurat që duhet zbatuar për ndryshimin e statudit ose programit politik të partisë;
- (c) procedurat që duhet zbatuar nga partia për shpërndarjen e saj, hyrjen në koalicion elektoral apo bashkimin me parti tjetër;
- (d) procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv ose të zyrtarëve të tjerë të zgjedhur të partisë;
- (e) procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të kuvendeve komunale duke marrë parasysh nenin 14;
- (f) krijimin e një organi për zgjidhjen e kontesteve brenda partisë lidhur me interpretimin e statudit;
- (g) kalimin e gjithë pasurisë së mbetur pas shlyerjes së të gjitha borxheve me rastin e shpërndarjes së partisë dhe
- (h) kohëzgjatjen dhe rregulloren e punës që duhet zbatuar në kuvendet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të partisë, duke përfshirë edhe sigurimin e kuorunit, rendit të ditës dhe të vendimmarrjes.¹⁸

¹⁶ Shih rregulloren e KQZ-së Nr.14/2009 mbi Sanksionet dhe Gjyqësorja, neni 3

¹⁷ Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, neni 12.

¹⁸ Rregullorja për Regjistrimin e Partive Politike, neni 12.

2.7 Një rol më i madh për Zyrën për regjistrimin e partive politike të KQZ

Në bazë të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Kreun III, Neni 11, sanksionohen me dispozita të përgjithshme regjistrimi dhe certifikimi i subjekteve politike. Në këtë nen rregullohet themelimi dhe funksionimi i Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike. Themelimi dhe funksionimi i zyrës është paraparë edhe me Rregulloren për Regjistrimin e Partive Politike. Të njëjtat dispozita të përgjithshme që janë të inkorporuara në Ligjin e sipërpërmendur janë edhe në këtë rregullore. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në garën për postet publike dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarimin financiar të këtij ligji.¹⁹ Kjo zyrë udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv dhe i raporton drejtpërdrejtë Sekretariatit të KQZ-së.

Duke i marrë për bazë kompetencat e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, vlen të theksohet që mbarëvajtja dhe funksionimi demokratik i subjekteve politike përpos tjerash është edhe përgjegjësi e kësaj zyre. Rregullorja për Regjistrimin e Partive Politike, përpos tjerash, definojnë qartë edhe mënyrën e zgjedhjes së kandidatëve elektoral. Gjithashtu, një nen tjetër me rëndësi në këtë Rregullore është edhe Neni 17 i cili përkufizon dhe specifikon se si duhet të financohet një parti politike nga individë të caktuar, anëtarësia e partisë dhe nga buxheti i Kosovës.

Detyrë e Zyrës është që të monitorojë funksionimin e partive përbrenda, duke vëzhguar dhe duke raportuar për zhvillimet në të gjitha nivelet në parti. Kjo nënkupton vëzhgimin e zgjedhjeve dhe raportimin e madje edhe sanksionimin e partive nëse ato nuk u përmbahen Rregullores dhe statutit të tyre. Për realizimin e kësaj detyre, Zyra ka nevojë për numër shumë më të madh të personelit se sa që ka tani e që do të monitorojë në tërë Kosovën dhe në një afat më të gjatë punën e partive politike dhe të raportojë drejt për të gjitha nivelet dhe për të gjitha zhvillimet.

Sipas vlerësimeve të ekspertëve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike që vepron në kuadër të KQZ-së ka dështuar të luajë rolin që duhet të ketë. Kjo ka ndikuar negativisht edhe te partitë politike pasi ato nuk janë ndier të obliguara që t'u përmbahen kërkesave ligjore për funksionim të partive. Intervistat e KIPRED me ekspertë²⁰ zbulojnë se shkak kryesor që kjo Zyra nuk performon ashtu siç duhet është mungesa e kapaciteteve. Zyra nuk ka personel të mjaftueshëm për t'i kryer detyrat që i kërkon ligji. Gjithashtu, vlerësohet se ka mungesë të integritetit profesional të stafit të zyrës që di të lakohet para presioneve të politikës. Hulumtimet për këtë raport kanë zbuluar se – për shembull – KQZ kishte ndryshuar vlerësimin e vet për statutin e ri të KDTP-së pas presioneve të politikës. KQZ, më 23.03.2012 kishte përpiluar një përgjigje prej 5 faqesh me të cilën sqaron se vendimet e marra në një takim pune (iftar) nuk janë të ligjshme, përfshirë edhe ndryshimet në Statut. Mirëpo, kjo përgjigje nuk u është dhënë palëve zyrtarisht. Palët kanë marrë përgjigje zyrtare që mban datë 24.05.2012 ku në një faqe e gjysmë thuhet se “nuk ka shkelje të theksuara” në procedurë dhe

¹⁹ Ligj për Zgjedhjet e Përgjithshme, kreu III – Dispozitat e Përgjithshme

²⁰ Ekspertë të zgjedhjeve, zyrtarë të OSBE dhe të KQZ, të cilët preferojnë të mbesin anonimë, intervista të KIPRED, maj-qershor 2012.

pranon ndryshimet e bëra, përfshirë edhe miratimin e statutit të ri të partisë.²¹ Ka arsye të besohet se KQZ ka ndryshuar mendimin dhe ka pranuar ndryshimet e reja në dokumentet e KDTP-së edhe pse ka pasur shkelje procedurale. Rasti i KDTP-së tregon pasojat e mosfuqizimit të kësaj Zyre dhe pasojat e ndikimit të politikës në punën e saj.

Sikur të zbatoheshin në përputhshmëri korniza ligjore për funksionimin e partive politike dhe sikur të kishte sanksione të mirëfillta për partitë që shkelin këtë kornizë, atëherë do të kishte shumë më tepër demokraci funksionale brenda partive politike në vend. Sikur të respektoheshin dispozitat aktuale për funksionim të partive politike, atëherë ligji ekzistues për Zgjedhjet e përgjithshme por edhe ata të mëparshmit që parashihnin listat e mbyllura do të mjaftonin të garantohej një nivel i lartë i demokracisë në Kosovë²².

Fuqizimi i Zyrës duhet të jetë ndër prioritetet e çfarëdo reforme politike në Kosovë. Një Zyrë e fortë që mund të sanksionojë partitë e madje edhe t'ua ndalojë pjesëmarrjen në zgjedhje, një zyrë me integritet profesional që nuk do të lejojë tërheqjen para presioneve të politikës dhe një Zyrë që do të informojë rregullisht edhe opinionin publik, më saktësisht elektoratin, do të mund të luante rol qenësor në shtyrjen përpara të demokracisë brenda partive politike në Kosovë.

²¹ KIPRED ka parë të gjitha këto dokumente, ato që u janë dorëzuar palëve zyrtarisht por edhe ato që ishin përpiluar por nuk ishin dorëzuar zyrtarisht palëve.

²² Ekspertë të pavarur të zgjedhjeve, pjesëtarë të KQZ-së si dhe me personel i Misionit të OSBE-së në Kosovë, të cilët preferuan të mbeten anonimë, intervista të KIPRED, maj-qershor 2012.

3. PRAKTIKAT NË PARTITË POLITIKE

3.1 Partia Demokratike e Kosovës – PDK

Partia Demokratike e Kosovës është themeluar me 10 tetor të vitit 1999. Kryetari i saj që nga themelimi është z.Hashim Thaçi, aktualisht kryeministër i Kosovës në mandatin e dytë. PDK-në e themeluan kryesisht ish-pjesëtarë të UÇK-së dhe LPK-së duke bartur kështu në parti frymën kryengritëse dhe luftarake që ka karakterizuar këto dy organizata.

PDK është e organizuar në seksione, nëndegë, degë dhe në nivelin qendror. Kongresi është organi më i lartë i partisë²³ i cili ndër të tjera zgjedh Këshillin Drejtues dhe Kryetarin e partisë. Lista e kandidatëve për Këshillin Drejtues propozohet nga Kryesia dhe plotësohet me propozime nga delegatët e Kongresit. Këshilli Drejtues përbëhet prej 81 anëtarëve me mandat dy vjeçar²⁴. Këshilli Drejtues propozon statutin dhe programin e partisë si dhe zgjedhë anëtarët e Kryesisë. Kryesia e cila përbëhet prej 29 anëtarëve është organ drejtues dhe ekzekutiv. Anëtarët e Kryesisë zgjedhën nga Këshilli Drejtues, kurse këta të fundit zgjedhën nga Kongresi me propozime të Kryesisë. Ky proces i emërimeve të ndërsjella mund të konsiderohet si konflikt interesi dhe lë hapësirë për manipulim të procesit. Kryetari i PDK-së ka mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje²⁵ dhe i raporton Kongresit, Këshillit Drejtues dhe Kryesisë. Statuti i partisë parasheh marrjen e vendimeve me konsensus ose me votim²⁶ duke mos theksuar mënyrën e votimit nëse është i hapur apo i mbyllur.

Që nga themelimi i institucioneve të vendit, PDK vetëm në një mandat ka qëndruar në opozitë, kurse në gjithë të tjerët ka qenë pjesë e pushtetit. Në zgjedhjet e vitit 2007, PDK doli forca kryesore politike dhe prej atëherë ka qeverisur me vendin. Aktualisht, pjesa më e madhe e strukturave udhëheqëse të PDK-së bartin poste qeveritare, gjë që ka dobësuar mënyrën e organizimit dhe funksionimin e brendshëm të partisë. Sekretari i Përgjithshëm i cili duhet të jetë hallka kryesore e organizimit dhe koordinimit të punëve në parti, pothuajse ka ngrirë postin e tij ngase i njëjti ushtron edhe atë të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Zyrat e PDK-së janë të boshatisur nga zyrtarët e saj, madje aty nuk gjendet as zëdhënësi i saj i cili është ngarkuar me post ministror.

Si pasojë e kësaj, partia nuk ka arritur të jetë e rregullt me zgjedhjet brenda partisë. Kuvendi i fundit zgjedhor i PDK-së është mbajtur në tetor të vitit 2010 por pa u mbajtur paraprakisht edhe zgjedhjet brenda-partiake nëpër degë. Zyrtarë të partisë e pranojnë se partia ka nxituar që të “kënaqë ligjin” pasi ishte e konsumuar si parti nga marrja me qeverisje. Në vitin 2012, megjithatë, të dhënat tregojnë për një ringjallje të angazhimit në parti. Nga zyrtarë të partisë mësohet se në vitin 2012 janë mbajtur 30 mbledhje të Kryesisë²⁷. PDK ka formuar Komisionin për reformë që udhëhiqet nga Sekretari i partisë, z.Jakup Krasniqi dhe në muajin mars është marrë vendimi që të mbahen zgjedhjet në parti ndonëse ende nuk është dhënë një

²³ Partia Demokratike e Kosovës, Statuti, neni 13.1

²⁴ Po aty, neni 21.2

²⁵ Po aty, neni 24.2

²⁶ Po aty, neni 38

²⁷ Hajredin Kuçi (Nën-kryetar i PDK-së), intervistë në Prishtinë, 20 qershor 2012.

datë se kur do të mbahen këto. Sipas zyrtarëve të partisë, zgjedhjet janë vonuar për shkak të zgjedhjeve për Kryetar Komune që u mbajtën një herë në Ferizaj e pastaj në Kaçanik. Në zgjedhjet që planifikohen të mbahen në të gjitha nivelet, pritet të ketë përballje mes dy fraksioneve të brendshme që kanë lindur ndërkohë. PDK deri më tani ishte shquar për unitet të brendshëm dhe vendimmarrje konsensuale por uniteti i partisë është duke u sfiduar nga nënkryetari i partisë, z.Fatmir Limaj, i cili ka shfaqur publikisht pakënaqësi me mënyrën e drejtimit të partisë por edhe me qeverisjen nga kryeministri Thaçi. Z.Limaj, që është njeriu i dytë më i votuar i partisë nga elektorati, ka kritikuar mënyrën e përzgjedhjes së deputetëve dhe partnerit të koalicionit nga ana e kryetarit të partisë²⁸. Ende nuk dihet nëse Thaçi dhe Limaj do të kandidojnë për të parin e partisë apo do të ketë një kandidat të tretë dhe kjo është arsyeja e vërtetë e zvarritjes së procesit të zgjedhjeve të brendshme²⁹. Kandidat i mundshëm për postin e kryetarit të PDK-së përmendet z.Kadri Veseli, udhëheqës i ish-Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK)³⁰.

Zyrtarë të partisë nuk i marrin për të keq kritikën e shprehura por i cilësojnë si pjesë të debatit që zhvillohet edhe në parti³¹. Ata shprehen se karakteristikë e PDK-së është fryma e rebelizmit e që karakterizon shumicën e personaliteteve që e kanë themeluar partinë e që janë zyrtarë të lartë të saj. Ky karakter rebelues do të thotë se në PDK jo vetëm që ka debat por janë të shpeshta rastet kur zyrtarët e partisë ngrehen kundër vet liderit të partisë dhe kjo vetëm sa e ngrit cilësinë e debatit dhe të demokracisë brenda partisë³².

Fuqia e z. Thaçi, si kryetar i partisë, është mu aftësia që ka që të pajtojë të gjithë këta “rebelë” dhe të marrë pajtimin e të gjithëve për të gjitha temat dhe vendimet që duhet marrë në parti. Falë kësaj aftësie duket që PDK nuk vuan aq shumë nga sfida e prurjeve të reja në parti, sfida nga e cila vuajnë partitë tjera³³.

Nënkryetari Kuçi duke hedhur poshtë deklaratat se partia është lënë pas dore përmend se vet kryetari i partisë ka qenë i përfshirë në zgjedhjen e kandidatëve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik. Ai e mbron angazhimin e Qendrës në zgjedhjet e kandidatëve për komuna duke thënë se kjo është bërë vetëm aq sa të pengohet “tiranania e votës” që të zgjidhet dikush që ka votat e degës por jo detyrimisht edhe votat e elektoratit.

Si forcë kohezive në parti përmendet përvoja patriotike dhe kryengritëse e anëtarëve dhe zyrtarëve të partisë por edhe aftësia e partisë për të akomoduar prurjet e reja që i bën anëtarët e ri në parti që të ndjenjë se mund të kontribuojnë njësoj.

Si sfida kryesore për partinë mbetet profilizimi i partisë dhe artikulumit i një ideologjie. Kjo është sfida afatgjatë për partinë pasi një profilizim më i qartë do të marrë disa vite dhe ky do

²⁸ Shih: <http://koha.net/?page=1,13,100162> (hapur për here të fundit më 21.06.2012).

²⁹ Shih: <http://koha.net/?page=1,13,98724> (hapur herën e fundit më 21.06.2012).

³⁰ Shërbimi i Inteligjencës i Kosovës ishte shërbim për zbulim dhe inteligjencë i lidhur me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës gjatë luftës dhe me Partinë Demokratike të Kosovës pas luftës. Z.Kadri Veseli, udhëheqës i SHIK-ut, është shprehur në media vazhdimisht se SHIK më nuk vepron.

³¹ Shih: <http://koha.net/?page=1,13,100232> (hapur për here të fundit më 21.06.2012).

³² Hajredin Kuçi (Nën-kryetar i PDK-së), intervistë në Prishtinë 20 qershor 2012.

³³ Hajredin Kuçi (Nën-kryetar i PDK-së), intervistë në Prishtinë 20 qershor 2012.

të jetë një prej çelësave për të ruajtur dhe shtuar elektoratin si dhe për të garantuar prurjet e reja në parti.

Sfidë për partinë, sikur edhe profilizimi, megjithatë duket se është edhe imazhi i partisë. PDK, që ishte themeluar menjëherë pas luftës me ambicien që të kapitalizonte meritat e UÇK-së, pësoi nga njollat që ju veshën UÇK-së, qoftë me të drejtë, qoftë pa të drejtë. PDK nuk ishte në gjendje të distancohej nga krimi që bëhej në emër të UÇK-së. Në zgjedhjet e para komunale që u mbajtën në vitin 2000 nuk doli fitimtare PDK-ja por LDK-ja. Prej atëherë, PDK nuk ka arritur të rrisë elektoratin e saj dhe në çdo palë zgjedhje të mbajtura merr rreth 200.000 vota.

Viti i zgjedhjeve	2001	2004	2007	2010
Numri i votave	202622	199112	196207	224339

Marrja e primatit si partia më e madhe në Kosovë del se nuk është aq shumë meritë e PDK-së sa është “meritë” e LDK-së e cila humbi më shumë se gjysmën e elektoratit të vet. Imazhi i PDK-së ka vazhduar të dëmtohet me akuzat për krime lufte të ngritura kundër zyrtarëve të lartë të saj, nga akuzat e Këshillit të Evropës në raportin e njohur me emrin e autorit të raportit Dick Marty, me akuzat për përfshirje të anëtarëve e zyrtarëve të saj në afëra korruptive, si dhe me akuzat për veprimtari kriminale të SHIK-ut. Tash së voni partia u përball edhe me shkarkimin e dy kryetarëve komunash për kryerje të veprave penale. PDK është duke u sfiduar edhe në kredencialet patriotike. Lëvizja VETËVENOSJE, që është bërë subjekti politik më i zëshëm opozitar, po e lufton në lojën se “kush është më patriot” duke e akuzuar PDK-në për tradhti në çështjet siç është dialogu mes Kosovës e Serbisë.

Për PDK-në ndoshta më me rëndësi se profilizimi i partisë do të jenë zgjedhjet që do të mbajë partia këtë vit dhe aftësia për të zgjedhur në mënyrë demokratike e të drejtë kandidatë që pëlqehen nga elektorati e të cilët do të përmirësojnë imazhin e partisë.

3.2 Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

Lidhja Demokratike e Kosovës është partia politike më e vjetër në vend, e themeluar më 23 dhjetor të vitit 1989. Kryetar i saj është Isa Mustafa i zgjedhur në vitin 2010. LDK është e vetmja nga partitë e mëdha në krye të së cilës nuk është më themeluesi i partisë dhe ka pasur tre kryetar të ndryshëm.³⁴ Forca kryesore kohezive konsiderohet të jetë përkatësia e lidhur me Presidentin Ibrahim Rugova dhe lëvizjen për pavarësi.³⁵

LDK në Kuvendin e VII-të zgjedhor, të mbajtur në mars të vitit 2012, ka aprovuar statutin e ri të saj. Qëllimi i ndryshimit të statutit ishte përshtatja zhvillimeve dhe rrethanave të reja të krijuara, si në parti ashtu edhe në vend. Gjithashtu, statuti i parë ishte hartuar në kohën kur LDK kishte funksionuar më shumë si lëvizje politike se sa si parti dhe rrjedhimisht

³⁴ Ibrahim Rugova nga viti 1989 deri më 2006, Fatmir Sejdiu nga viti 2006 deri më 2010 dhe Isa Mustafa nga viti 2010.

³⁵ Isa Mustafa, (Kryetar i LDK-së), intervistë në Prishtinë, 21 maj 2012.

ndryshimet në statut ishin të domosdoshme. Sipas statutit në fuqi, LDK është e organizuar në degë dhe nëndegë duke shuar kështu aktivet të cilat vepronin sipas statutit të vjetër. Organi më i lartë i LDK-së është Kuvendi i cili përbëhet prej 355 delegatëve të zgjedhur në Kuvendet e degëve.³⁶ Kuvendi zgjedh Kryetarin e partisë me votim të fshehtë dhe me më shumë kandidat si dhe Këshillin e Përgjithshëm i cili përbëhet prej 99 anëtarëve.³⁷ Këshilli i Përgjithshëm më pas zgjedhë Kryesinë e cila përbëhet prej 25 anëtarëve.³⁸ Kryetari i LDK-së njëkohësisht është kryetar i të gjitha organeve ekzekutive.

Në vitet e fundit LDK është ballafaquar me sfida të ndryshme. Për vite me radhë posti i kryetarit të LDK-së ka qenë i ngrirë ngase të njëjtit kanë ushtruar funksionin e Presidentit të Republikë së Kosovës. Mos-ushtrimi i funksionit të kryetarit ka lënë vakum në menaxhimin e partisë duke shfaqur nevojën që LDK t'i nënshtrohet një procesi të thellë reformues.

Sfidë tjetër me të cilët aktualisht përballet LDK-ja është ripërtëritja e strukturave udhëheqëse pa e cenuar kohezionin dhe bashkëpunimin në mes gjeneratave³⁹. Në vitin 2006, LDK kishte filluar procesin e reformave të brendshme, proces ky që kishte hasur në rezistencë për faktin se kishte për qëllim krijimin e hapësirave për kuadro të reja.⁴⁰ LDK është duke u përpjekur të institucionalizojë inkuadrimet e reja. Një nga format është e drejta e kryetarit për të marrë iniciativë për zgjedhje kuadrosh,⁴¹ kurse formë tjetër konsiderohet të jetë edhe krijimi i Grupit të ekspertëve, i cili kryesisht përbëhet nga ekspert të profileve të ndryshme, shumica anëtarë të LDK-së por jo të inkuadruar në strukturat e partisë. Statuti i ri gjithashtu parasheh kompetenca më të zgjeruara për kryetarin e partisë, me propozimin e të cilit Këshilli i Përgjithshëm zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm.⁴² Këto kompetenca mund të shihen edhe si tendencë për të rritur kontrollin në parti dhe promovimin e anëtarëve që janë më të afërt me liderin.

Raportimi në parti është i rregullt, brenda partisë si dhe në KQZ. Raportimi është me shkrim e jo vetëm gojor. LDK po shfrytëzon internetin për të përmirësuar raportimin dhe publikon çdo muaj, apo edhe sipas nevojës, një “newsletter” si një mënyrë shtesë për të komunikuar.

Përpjekjet për reformim të brendshëm nganjëherë kanë shkaktuar efekte negative. Procesi i zgjedhjeve të brendshme dhe përballet e kundër-kandidatëve ka rezultuar me përçarje dhe fraksione, e madje edhe me krijimin e subjekteve të reja politike nga pjesa e pakënaqur me proceset zgjedhore. Ajo që më së shumti është dëmtuar nga ky proces ka qenë vetë LDK e cila pas çdo Kuvendi Zgjedhor ka rezultuar me humbje të elektoratit, përveç Kuvendit të fundit zgjedhor të mbajtur në vitin 2010.

LDK deri më tani ka qenë pjesë e të gjitha legjislativave të Kuvendit të Kosovës. Në legjislativën e V-të ajo përfaqësohet me 27 deputetë. LDK në Kuvendin e Kosovës kryeson

³⁶ Lidhja Demokratike e Kosovës, Statuti, neni 18.1.

³⁷ Po aty, neni 23.1.

³⁸ Po aty, neni 28.

³⁹ Isa Mustafa, (Kryetar i LDK-së), intervistë në Prishtinë, 21 maj 2012.

⁴⁰ Ismet Beqiri, (Sekretar i përgjithshëm i LDK-së dhe shef i grupit parlamentar) intervistë në Prishtinë, 23 maj 2012.

⁴¹ Lidhja Demokratike e Kosovës, Statuti, neni 26.

⁴² Lidhja Demokratike e Kosovës, Statuti, neni 24.

tri komisione parlamentare, atë për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Legjislacioni si dhe Integrimi Evropian. Para seancave plenare, grupi parlamentar mbledhet për t'i diskutuar pikat e rendit të ditës. Grupi parlamentar merr parasysh edhe vlerësimet e Këshillit të Ekspertëve që është krijuar brenda LDK-së. Grupi parlamentar i LDK-së në vazhdimësi i koordinon punët me këtë grup, Kryesinë e partisë por edhe me Kryetarin në raste kur ka të bëjë me qëndrime të mëdha.⁴³ Këtë e pohon edhe kryetari i LDK-së Isa Mustafa i cili thotë se “edhe pse hezitohet të përfshihem në punën e përditshme të deputetëve, duhet të pranoj se jam përfshirë në momente të rëndësishme për Kosovën siç ishte zgjedhja e Presidentit, përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë apo reforma elektorale”.⁴⁴

Lidhja Demokratike e Kosovës aktualisht është partia kryesore opozitare në Kosovë. Ndonëse ishte partia më e madhe, LDK është partia politike që ka humbur më së shumti elektorat në Kosovë. Përçarjet brenda partisë dhe sfida e transformimit në një parti politike të mirëfilltë janë ndër shkaqet e humbjes së elektoratit.

Thënë me shifra, LDK ka humbur më shumë se gjysmën e elektoratit që ka pasur në zgjedhjet e para të mbajtura mbas luftës. Inkurajuese për partinë mund të jetë e dhëna që megjithatë, në zgjedhjet e fundit është ndërprerë trendi negativ dhe partia ka arritur të kthejë një pjesë të votave. Thënë me numra, lëvizja e votave për LDK-në duket kështu:

Viti i zgjedhjeve	2001	2004	2007	2010
Numri i votave	359851	313437	129410	172552

E themeluar në fillim të lëvizjes për pavarësimin e Kosovës, LDK ka funksionuar më shumë si lëvizje se sa si parti. Autoriteti i LDK-së ndër shqiptarët e Kosovës që sfiduar fuqishëm nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që u përjetua si kundërshtarë e politikës së rezistencës paqësore që e promovonte LDK dhe themeluesi dhe lideri i saj, z. Ibrahim Rugova.

Gjatë viteve nëntëdhjetë forcë kohezive në LDK u bë angazhimi për pavarësimin e vendit. Pas luftës, pasi Kosova ende nuk e kishte arritur pavarësinë, angazhimi për këtë synim mbeti boshti i ideologjisë së partisë. Programet politike të LDK-së në vitet e pasluftës ishin mediokre, për të mos thënë qesharake, pasi ishin jo më shumë se një listë dëshirash për dardha turshi e kumësht bore. Shkak kryesor ishte se në esencë LDK kishte mbetur po ajo lëvizja që kishte filluar si përgjigje ndaj represionit kundër shqiptarëve, si artikulum i kërkesës së shqiptarëve të Kosovës për pavarësi. Në kushtet e pasluftës, kur Kosova u përball me më shumë se sa vetëm nevojën për pavarësi, LDK-ja nuk ishte në gjendje të artikulonte këto nevoja të reja të qytetarëve.

LDK është një hap përpara në krahasim me partitë tjera në profilizimin e vet ideologjik. Tash vonë, LDK, që veten e ka cilësuar gjithmonë si parti e djathtë, është afruar me Partitë Popullore Evropiane dhe po synon që të bëhet anëtare e këtij klubi. Ky do të jetë konfirmimi i parë se LDK është parti e qendrës së djathtë.

⁴³ Ismet Beqiri, (Sekretar i përgjithshëm i LDK-së dhe shef i grupit parlamentar) intervistë në Prishtinë, 23 maj 2012.

⁴⁴ Isa Mustafa, (Kryetar i LDK-së), intervistë në Prishtinë, 21 maj 2012.

Sot forcë kohezive në parti mbeten lidhjet dhe simpatitë e vjetra e më pak bindja – sidomos ndër të rinjtë – se në LDK mund të gjejnë hapësirë për të realizuar ambiciet e tyre politike.

Përtëritja e kuadrove dhe rezistenca e gjeneratave mbetet sfida kryesore e partisë. Këtë e pranojnë edhe zyrtarët më të lartë të partisë. Shumë kuadro që kanë qenë pjesë e partisë që nga themelimi i saj dhe që konsiderojnë që kanë sakrifikuar shumë për partinë deri tani, nuk pranojnë të lënë postet e tyre në parti edhe atëherë kur shihet qartë se e kanë humbur besimin e votuesve dhe rrjedhimisht, duke mbajtur ende poste partiake, mund të dëmtojnë imazhin e partisë para elektoratit. Kjo u pa qartë në zgjedhjet për Kryetar Komune që u mbajtën këtë pranverë në Ferizaj dhe në Kaçanik. Kandidati i LDK-së për Kryetar Komune në Ferizaj, z. Adem Salihaj, në fakt e kishte përjashtuar qendrën nga vendim-marrja për kandidatin për këtë garë, duke e shkelur statutin e partisë. Qendra nuk ishte në gjendje ta kundërshtonte atë pasi z. Salihaj e kontrollon degën në Ferizaj. Preferencat e elektoratit nuk i mori parasysh as dega e rrjedhimisht as qendra. Më keq se në Ferizaj LDK kaloi në Kaçaniku, ku kandidati që e kishte nxjerr dega nuk arriti të dilte as i dyti në garë dhe mori vetëm 5 për qind të votave.

Ndeshjen e gjeneratave e pranon si sfidën më të madhe edhe z. Isa Mustafa, kryetar i LDK-së. Kryetari Mustafa tregohet i vetëdijshëm për nevojën për reformim të partisë. Ai thotë se në parti është “duke u ndërtuar një infrastrukturë dhe një sistem demokratik”⁴⁵ dhe përmend numrin e mbledhjeve të Këshillit të Përgjithshëm, Statutin e ri të partisë dhe ndryshimet si votimi i fshehtë si ndër të arriturat e këtij procesi.

Edhe vëzhguesit nga jashtë shohin përparime në LDK. Zgjedhjet partiake në nivel të degëve, madje edhe ato të vitit 2006, nga vëzhguesit përmenden si shembull i mirë i zgjedhjeve të brendshme, ndonëse përmenden rastet kur në ndonjë degë ka pasur vetëm një kandidat për kryetar që nuk cilësohet si praktikë e mirë demokratike. Megjithatë, në Kuvendin e Përgjithshëm të vitit 2006 zhvillimet nuk ishin aspak demokratike dhe sollën deri te dalja nga partia e një pjese që formoi më pas Lidhjen Demokratike të Dardanisë.

Kryetari i partisë, z. Mustafa, pranon se ka rezistencë të cilën thotë se e ka përjetuar edhe vet pasi edhe ai vet, në njëfarë mënyre, është prurje e re në LDK. Ai shprehet se ndonëse ka qenë i brengosur në fillim, tani është krijuar hapësirë për prurje të reja në LDK dhe shton se “janë inkadruar 20 anëtarë të ri në Këshillin e Përgjithshëm”.⁴⁶ LDK ka themeluar Këshillin e Ekspertëve si një forum ku mund të angazhohen emra të ri për të kontribuar në parti. Në të vërtetë, themelimi i këtij Këshilli të Ekspertëve duket më shumë si rezultat i rezistencës së kuadrove të vjetëra karshi prurjeve të reja si dhe nevojës për të krijuar hapësirë për kuadrot e reja dhe për të mirënjohur kontributin dhe rolin e prurjeve të reja.

Një përparësi që ka LDK-ja, në krahasim me partitë tjera e që mund ta bëjë më të lehtë demokracinë brenda partisë, është fakti që lideri dhe themeluesi i partisë, z. Ibrahim Rugova, nuk është më. Sipas një vëzhguesi të pavarur, në Kosovë partitë politike janë të lidhura ngushtë me themeluesin dhe është vështirë të ndërrohet nga posti i liderit. LDK e ka kaluar këtë pikë dhe gara për kryetar të partisë është më e hapur.

⁴⁵ Isa Mustafa, (Kryetar i LDK-së), intervistë në Prishtinë, 21 maj 2012.

⁴⁶ Isa Mustafa, (Kryetar i LDK-së), intervistë në Prishtinë, 21 maj 2012.

Kryetari i LDK-së shprehet i vetëdijshëm për sfidat në demokratizimin e partisë përbrenda. Ai pranon se parimet demokratike si dhe vet dokumentet themelore të partisë vazhdojnë të sfidohen. Zgjedhja e z.Adem Salihaj për kandidat të LDK-së në zgjedhjet për Kryetar Komune në Ferizaj në pranverën e vitit 2012, përçarjet brenda partiake në Gjakovë si dhe në Forumin e Rinisë në Podujevë janë shembuj konkret të mosfunksionimit të demokracisë në parti. Por, z.Mustafa, duke i pranuar këto sfida si dhe duke mos pranuar të flasë për ndikimet nga jashtë në parti, shton se në parti nganjëherë ka konfuzion dhe demokracia shihet si anarki por shprehet i vendosur që në parti të vihet rend dhe një sistem që do të mbijetojë çdo kryetar të partisë dhe do të garantojë demokraci brenda partisë.

Të kënaqur me zhvillimet brenda partisë shprehen edhe zyrtarë të tjerë të partisë me të cilët ka biseduar KIPRED. Sipas tyre, deri sa më herët LDK ka qenë në kaos të plotë, tash në LDK ka filluar të vihet rend.

Mirëpo, kjo kënaqësi me të arriturat në parti nuk po vërehet nga jashtë. LDK, për të mbijetuar, duhet të ndryshojë kahun e momentumit politik dhe ta kthejë nga rënia në ngritje. Deri tani, në opinion kanë rënë në sy vetëm çarjet dhe ikjet nga LDK-ja të cilat kanë ndodhur në secilin Kuvend të Përgjithshëm dhe janë përcjellë me bujë nga mediat dhe opinion publik më së shumti për shkak se këto dalje nga partia janë përcjellë me skena si ato të vitit 2006 kur debatin e kishin ngufatur armët e zjarrit dhe hedhja e karrigeve.

Mbijetesa e LDK-së, që nganjëherë vihet në pikëpyetje, është e rëndësishme për demokracinë politike në Kosovë. Sfida e tejkalimit të çarjeve të shkaktuara nga rezistenca e “gardës së vjetër” është qenësore për të ardhmen e partisë por edhe të demokracisë në Kosovë. Testi i gjetjes së hapësirës për kuadro të reja do të jetë kryesor për të ardhmen e partisë. Nëse LDK e kalon këtë test, atëherë mund të bëhet shembull edhe për partitë tjera në Kosovë.

LDK duhet të fillojë të shihet nga elektorati si parti e mirëfilltë, e profilizuar qartë e jo vetëm të jetojë nga kujtesa për z. Ibrahim Rugova, me integritet për të marrë mbi vete përgjegjësitë dhe të veprojë ndërgjegjshëm qoftë kur është në pushtet, qoftë kur është në opozitë. Deri tani, LDK edhe pse është në opozitë, nuk po shihet si e tillë nga opinion publik në Kosovë. Për të mbijetuar partia, tejkalimi i tërë këtyre sfidave nuk duhet të kënaqë vetëm zyrtarët e partisë por duhet t’i kënaqë edhe votuesit e LDK-së, ata që i kanë mbetur besnik partisë si dhe ata që i kanë kthyer shpinën njëherë por edhe më shumë votuesit e ri që do të jenë zgjedhësit e ardhshëm në Kosovë.

3.3 “Lëvizja VETËVENDOSJE!” – LVV

“Lëvizja VETËVENDOSJE!” është themeluar më 12 qershor të vitit 2005. Aktivitetin e saj e kishte filluar si nismë qytetare, për t’i hyrë garës elektorale në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Që nga themelimi, lider i “Lëvizjes VETËVENDOSJE!” është Albin Kurti. Përfaqësues dhe simpatizantë të LVV mendojnë se ende janë në fazën e sakrificës dhe prej këtu buron edhe kohezioni i kësaj iniciative, pa lënë anash programin dhe debatin e

brendshëm⁴⁷. Edhe pse për shumë kë Albin Kurti është forca kohezive në këtë subjekt, ai vet mohon një që të tillë. Këtë e arsyeton me faktin se në zgjedhjet e vitit 2010 kishte marr rreth 37% më pak vota se sa numri i përgjithshëm i votave të subjektit. Albin Kurti forcën kohezive e sheh në tre komponentë: 1) Vetëdije të përbashkët; 2) Lidhjen me institucionet: duke pasur qëndrime koherente si ndaj bashkësisë ndërkombëtare, si në protestë ashtu edhe në paraqitjet mediale; si dhe 3) Lojalitetin ndaj metodës: ku deputeti nuk rri ulur në Kuvend, por del në protestë dhe arrestohet⁴⁸.

Pjesë e solidarizimit me “Lëvizjen” është edhe vendimi që deputetët e këtij subjekti të mbajnë vetëm 500 euro nga paga që e marrin si deputetë dhe pjesën tjetër t’i japin “Lëvizjes”. Së paku një përfaqësues i LVV në Kuvendin e Kosovës është shprehur se nuk e pëlqen këtë praktikë ndërsa një tjetër nuk ka pranuar që pagën t’ia dorëzojë Lëvizjes. Megjithatë, kjo nuk ka qenë arsye për “ndarje” me “Lëvizjen”.

Statuti i “Lëvizjes VETËVENDOSJE!” i është nënshtruar ndryshimeve të shpeshta, kjo edhe për faktin se çdokush mund të bëjë propozime për ndryshim-plotësim të statutit. Organet vendimmarrëse dhe ekzekutive janë të organizuara nga baza drejtë qendrës. Niveli i parë organizativ është Këshilli i Pikës, që vepron në nivel lagjesh dhe përbëhet nga të paktën 7 anëtarë por jo më shumë se 100⁴⁹. Niveli i dytë organizativ është Qendra, e cila organizohet në nivelin e një komune dhe themelohet me vendimin e Këshillit të Përgjithshëm. Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë vendimmarrës në nivelin e tretë organizativ⁵⁰ dhe mbledhet të paktën një herë në tre muaj. Ndërsa Kryesia prej 15 anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës në nivelin e tretë organizativ midis dy mbledhjeve të Këshillit të Përgjithshëm. Pjesë e Kryesisë nuk mund të jenë Kryetarët e komunave, këshilltarët komunalë, deputetët si dhe anëtarët e Kabinetit Qeveritar⁵¹. Mbledhjet e Kryesisë mbahen të paktën një herë në dy javë dhe ato i thërret dhe i drejton Kryetari i “Lëvizjes VETËVENDOSJE!”. Mbledhjet e Kryesisë nuk mund t’i thërret ndonjë nga anëtarët e tjerë të Kryesisë pa autorizimin e kryetarit⁵². Zgjedhja e kryetarit të “Lëvizjes VETËVENDOSJE!” bëhet drejtpërdrejt nga anëtarësia. “Lëvizja VETËVENDOSJE!” ka një statut mirë të definuar sa i përket përgjegjësisë, nivelit të llogaridhënies dhe kufizimit të mandateve. Me statut çdo mandat drejtues është i kufizuar në dy mandate⁵³. Për më tepër, në rast të zgjedhjes së kryetarit në postin e kryeministrit, ai është i obliguar të jap dorëheqje nga pozicioni i kryetarit.

“Lëvizja VETËVENDOSJE!” është e re në skenën politike të vendit dhe demokracia e saj e brendshme është akoma në fazën e zhvillimit. Ndikimi dhe fuqia e liderit në këtë subjekt është mjaft e shprehur dhe shihet si e natyrshme, ndonëse mohohet që kryetari aktual të ketë ushtuar ndonjëherë ndikimin e tij⁵⁴. Sfidë në VV konsiderohet të jetë zbatimi i tërësishëm i

⁴⁷ Dardan Molliqaj (Sekretar organizativ në LVV), intervistë në Prishtinë, 22 maj 2012.

⁴⁸ Albin Kurti, (Kryetar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!), intervistë në Prishtinë, 1 qershor 2012

⁴⁹ “Lëvizja VETËVENDOSJE!”, Statuti, neni 30.1

⁵⁰ Po aty, neni 61

⁵¹ Po aty, neni 68

⁵² Po aty, neni 69

⁵³ Po aty, neni 10

⁵⁴ Dardan Molliqaj, (Sekretar organizativ në Lëvizjen VETËVENDOSJE!), intervistë në Prishtinë, 22 maj 2012

demokracisë së drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Anëtarët e VV janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Pikës dhe nëse mungojnë më shumë se tre herë humbin këtë status duke u shndërruar në simpatizantë.

Ndonëse “Lëvizja VETËVENDOSJE!” ka program të vet politik, mbetet i paqartë profilizimi ideologjik i këtij subjekti. Paraqitjet e zyrtarëve të LVV në debate publike kanë vënë dyshime në orientimin e tyre pasi idetë e prezantuara kanë ngjasuar me politikat e kohës së socializmit, si për shembull ideja për formimin e kooperativave nëpër fshatra. Vetëm një herë është dëgjuar të thuhet në një debat politik që LVV është subjekt politik i qendrës. Sfidë e veçantë, në kuadër të profilizimit ideologjik të LVV-së, do të jetë pajtimi i personaliteteve me bindje të ndryshme, nga liberalë në politikë e ekonomi deri te marksistë e nacionalistë. Gjetja e një platforme që do të kënaqë të gjithë dhe që do të shërbejë si materie për të ndërtuar kohezionin e mirëfilltë në parti do të jetë ndër testet kryesore të pjekurisë së LVV-së.

LVV është regjistruar pranë KQZ-së si iniciativë qytetare prandaj nuk i nënshtrohet rregullave mbi raportim të partive politike. Përkundër kësaj, LVV është ndër raportuesit më të rregullt në Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim.

Megjithatë, formalizimi i angazhimit në parti – detyrimi për pjesëmarrje edhe në mbledhjet e Pikës së LVV-së në lagje dhe përjashtimi nëse dikush nuk është i rregullt në këto mbledhje – për dikë mund të tingëllojë edhe si detyrim e jo vetëm zgjidhje dhe mundësi për të kontribuar. LVV duhet të gjejë një formë më jo-formale të matjes së kontributit të anëtarëve dhe ithtarëve e jo vetëm me pjesëmarrjen teknike në mbledhje dhe aktivitete të LVV-së.

Bashkëpunëtorë të mëhershëm të z. Albin Kurti e akuzojnë atë për praktika jodemokratike në qeverisje, gjë që bashkëpunëtorët e tij të tashëm e mohojnë. Anëtarët e partisë flasin për respektim të secilit dhe për garë të barabartë për të gjithë. Si shembull e përmendin përpilimin e listës së kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 e në të cilën renditja e emrave ishte bërë në mënyrë alfabetike duke i lënë disa nga personalitetet kryesore si Visar Ymeri në fund të listës.

Për “Lëvizjen VETËVENDOSJE!” sfidë mbetet përpilimi i një programi politik bindës për elektoratin e Kosovës. Votat që LVV ka fituar në zgjedhjet e vitit 2010 ka gjasa që më tepër të jenë vota negative, pra vota kundër partive tjera në cilat elektorati ka humbur besimin, se sa votë për “Lëvizjen VETËVENDOSJE!” dhe liderin e saj apo programin e saj. Ndonëse përpjekjet për demokraci të brendshme duken impulsive, vështirë se kjo do të jetë bindëse edhe për elektoratin. Një profilizim më i qartë dhe më bindës është qenësor për të mbajtur elektoratin e tashëm por edhe për të bindur votuesit e ri potencialë që të votojnë për LVV.

3.4 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është themeluar më 2 maj 2000 si koalicion i 5 partive. Pas tërheqjes së dy partive nga koalicioni, AAK në vitin 2001 u regjistrua si parti e vetme e jo si koalicion. Që nga themelimi e deri më tani kryetar i saj është z. Ramush Haradinaj. Në vitin 2005, tre muaj pasi kishte marrë funksionin e kryeministrit të Kosovës, z. Haradinaj dha

dorëheqje nga ky post dhe iu dorëzua Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ku ende po përballet me akuzat për krime lufte. Që nga atëherë, Haradinaj nuk ka mundur të ushtroj postin e kryetarit të partisë dhe kjo pozitë vazhdon të mbetet vakante. Aleanca është parti me frymë lideriste dhe lideri është figura që mban kohezionin brenda partisë. Anëtarët dhe simpatizantët e saj mendojnë se u është marrë e drejta për të qeverisur prandaj edhe angazhohen që “Ramushin” ta bëjnë prapë kryeministër.⁵⁵

Kuvendi Qendror është organi më i lartë i partisë dhe mbahet një herë në tre vjet. Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues i cili është organ politik-ekzekutiv dhe mblidhet së paku një herë në muaj⁵⁶. Kuvendi Qendror gjithashtu zgjedh edhe Kryetarin e partisë, i cili më pas propozon Kryesinë e cila përbëhet prej më së paku 17 anëtarëve dhe miratohet në Këshillin Drejtues. Kryetari i AAK-së, me statut, ka të drejtën e kooptimit duke propozuar rritjen e anëtarëve të Kryesisë në çdo kohë dhe sipas nevojës. Të gjitha propozimet e tilla duhet të aprovohen nga Këshilli Drejtues.⁵⁷

Vendimet në AAK merren në Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e partisë, mbledhjet e së cilës mbahen të paktën një herë në dy javë. Zyrtarët e partisë konfirmojnë që angazhohen që rregullat të respektohen në masë sa më të madhe⁵⁸. AAK praktikon edhe takime në një Ambient Konsultativ të nënkryetarëve, sekretarëve dhe kryetarëve të komunave të cilat udhëhiqen nga kjo parti e që duhet të shërbejë si forum këshillëdhënës.

Takimet e grupeve parlamentare varen nga seancat plenare. Është praktikë e AAK-së që takimet me anëtarët e saj në Parlament t’i mbajë një apo dy ditë para seancës plenare. Në këto takime vendoset për temat që do të ngrehen jashtë rendit të ditës si dhe për qëndrimet e deputetëve për projekt-ligjet apo çështjet që do të diskutohen. Kryesisht respektohen analizat që bëhen nga deputetët që janë anëtarë të komisioneve përkatëse. AAK ka 12 deputet në Kuvendin e Kosovës dhe secili prej tyre është anëtar në njërin prej 12 komisioneve parlamentare.

Sfidat kryesore me të cilat përballet AAK është shtrirja e saj në tërë territorin e Kosovës, pasi që tradicionalisht mbështetje më të madhe ka pasur vetëm në pjesën e rrafshit të Dukagjinit. Sfidë tjetër janë strukturat e ardhura nga partitë e tjera. Kjo ka bërë që në AAK të ketë përfaqësim nga dy ekstreme të kundërta. Edhe pse kjo konsiderohet të ketë edhe anën e mirë por në mungesë të liderit këto dallime janë më të dukshme.⁵⁹

AAK raporton për financat dy deri në tre herë brenda vitit. Gjithashtu është e rregullt edhe në raportim në KQZ. Sekretari i përgjithshëm i partisë raporton për gjendjen dhe organizimin e punëve në degë. Në organet e partisë, raportimi është kryesisht me gojë përveç rasteve kur kërkohet ndonjë raport më i detajuar atëherë përgatitet edhe me shkrim. AAK së fundmi është ndëshkuar me gjobë nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ngase kishe

⁵⁵ Burim Ramadanaj (Sekretar i përgjithshëm i AAK-së), intervistë në Prishtinë, 22 maj 2012

⁵⁶ Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Statuti, neni 17

⁵⁷ Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Statuti, neni 42

⁵⁸ Burim Ramadanaj (Sekretar i përgjithshëm i AAK-së), intervistë në Prishtinë, 22 maj 2012

⁵⁹ Po aty.

dorëzuar informata të pa kompletuara dhe nuk ka respektuar afatin kohor që i është dhënë nga Zyra për t'i plotësuar këto informata.

Pengesë kryesore në zhvillim e partisë është bërë mungesa e liderit të saj, më saktësisht e drejta e kryetarit të partisë, z.Ramush Haradinaj, që të jetë aktiv në jetën politike dhe në aktivitetet e partisë. Kjo është reflektuar edhe në angazhimin e partisë që të zgjerohet gjeografikisht, që të marrë kuadro të reja në parti si dhe për profilizimin e partisë. Programi i partisë është i papërfunduar pasi puna në të ka ngecur. Largimi i liderit dhe humbja e pushtetit politik i ka kushtuar partisë edhe në xhep, pasi nuk ka arritur të sigurojë financues të ri. Sponsorë kryesorë të partisë mbasin bizneset nga zona e Dukagjinit ku e ka bazën kryesore partia.

Kryetari i partisë, z. Ramush Haradinaj, qe liruar një herë nga TPNJ por është detyruar që të kthehet në rigjykim të pjesshëm dhe mbetet duke e pritur verdiktin final. Në kohën sa ishte i lirë, z. Haradinaj qe përqendruar në fuqizimin e partisë duke ndryshuar statutin dhe duke kërkuar të sjellë kuadro të reja. Flitej shumë edhe për një afrim të AAK-së me LDK-në dhe mundësinë që këto dyja të bëjnë bashkë qeverinë. Por, largimi i kryetarit Haradinaj i ndërpreu të gjitha këto zhvillime.

Viti i zgjedhjeve	2001	2004	2007	2010
Numri i votave	61668	57931	54611	77130

Me të drejtën që i a kishte dhënë statuti i ri, z. Haradinaj kishte kooptuar në majë të partisë z.Blerim Shala, një nga emrat më të dalluar të shoqërisë civile në Kosovë, duke e emëruar nënkryetar të parë të partisë. Me largimin e z.Haradinaj dhe pamundësinë që të merret me funksionin brenda partisë, përgjegjësia kryesore për mbarëvajtjen e partisë i ra nënkryetarit të parë, z. Blerim Shala. Kjo nuk është pritur mirë nga “garda e vjetër” e partisë. Z.Shala akuzohet nga kolegët e partisë se ka tentuar që të marrë vendime për partinë krye në vete, pa konsultuar zyrtarët e tjerë të partisë dhe atë për çështje të rëndësishme siç është formimi i koalicioneve qeveritare. Për shkak të kësaj, marrëdhëniet mes z.Shala dhe shumicës së zyrtarëve tjerë të partisë janë ftohur dhe mbasin të tendosura. Kjo vërehet edhe me deklaratat që dalin nga partia dhe që shpesh herë ndodh të jenë të pakoordinuara apo edhe në kundërshtim me njëra-tjetrën. Është pak e mundur që z.Shala të marrë vendime për partinë pa pëlqimin e kryetarit të partisë, me të cilin, ndonëse në paraburgim në Hagë, zyrtarët e partisë kanë mundur të konsultohen në baza ditore nëpërmjet bisedave telefonike. Për të ruajtur kohezionin në parti u angazhua z.Daut Haradinaj, vëlla i kryetarit të partisë, i cili me afërsinë e tij familjare me liderin do të duhej të vepronte si urë lidhëse mes fraksioneve dhe pajtues i përçarjeve.

Për AAK-në, si parti që është deklaruar qartë se është parti lideriste, imperativ mbetet kthimi i liderit të saj, z.Ramush Haradinaj. Pa prezencën e kryetarit, partia nuk po tregohet e aftë të bëjë asgjë as në shtrirjen gjeografike e as në shtyrjen përpara të demokracisë brenda partisë si dhe akomodimin e pikëpamjeve dhe ideologjive të ndryshme që hasen tek zyrtarët e saj, duke

rrezikuar kështu gjasat që të fitojë elektorat të ri dhe të mbetet fuqi e rëndësishme politike në vend.

3.5 Aleanca Kosova e Re – AKR

Aleanca Kosova e Re është themeluar më 3 maj të vitit 2006. Themelues dhe kryetar i AKR-së është biznesmeni kosovar Behgjet Pacolli. Në shkurt të vitit 2011, z.Pacolli kishte dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit të AKR-së për t'u zgjedhur president i vendit. Pasi Gjykata Kushtetuese e kishte cilësuar zgjedhjen e tij si President të Kosovës vendim në kundërshtim me kushtetutën⁶⁰, z.Pacolli u tërhoq nga ky post pas vetëm 8 ditëve. AKR e ktheu atë përsëri në postin e kryetarit të partisë.

Forca kryesore kohezive brenda AKR konsiderohet të jetë ideja e zhvillimit ekonomik, e promovuar nga kryetari i partisë, z.Behxhet Pacolli⁶¹, ndonëse kjo ambicie, sikur edhe te partitë tjera, nuk është elaboruar asnjëherë më qartë. Shumë zyrtarë të partisë janë në marrëdhënie fafëfisnore me kryetarin e partisë, ndërsa për zyrtarë tjerë spekulohet se kanë hyrë në parti për shkak të përfitimeve financiare që u janë premtuar, fjalë këto që asnjëherë nuk janë dëshmuar.

Organi më i lartë në nivelin qendror të AKR-së është Kuvendi, i cili përbëhet nga shtatë delegatë prej Degëve të AKR-së, ndërsa pas zgjedhjeve qendrore, një delegat për çdo një mijë vota të fituara.⁶² Këshilli Drejtues është organi më i lartë politik dhe programor në mes të dy seancave të Kuvendit. Këshilli drejtues i AKR-së përbëhet nga 129 anëtarë. Këshilli Drejtues i AKR-së mban mbledhje të rregullta së paku 4 herë në vit.⁶³ Kryesia e AKR-së është organ politiko-ekzekutiv. Kryesia e AKR-së përbëhet nga 49 anëtarë të cilët propozohen nga Presidenti i AKR-së dhe i zgjedh Këshilli Drejtues.⁶⁴ Presidenti i AKR-së është organi individual më i lartë i AKR-së i cili vendos për udhëheqjen e drejtpërdrejtë të partisë. Mandati i Presidentit të AKR-së zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes.⁶⁵ Karakteristikë e AKR-së është që përveç postit të nënpresidentit ka edhe postin e zëvendës-presidentit⁶⁶, të cilët me propozimin e Presidentit i miraton Këshilli Drejtues.

AKR ishte befasia e zgjedhjeve të vitit 2007 pasi arriti të dilte si forca e tretë dhe atë vetëm disa muaj pasi partia ishte formuar. Shkapërderdhja e elektoratit të LDK-së, premtimet e AKR-së për fokusim në zhvillim ekonomik dhe besimi i elektoratit se kryetari i partisë, z.Behxhet Pacolli – që njihet si shqiptari më i pasur në botë – nuk do të korruptohet, janë disa nga arsytet që besohet se i sollën aq shumë vota AKR-së. Por, qysh në zgjedhjet e ardhshme, ato të vitit 2010, AKR mezi mori gjysmën e votave që kishte marrë në vitin 2007 dhe atë pasi

⁶⁰ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vendimi Nr.04-V-04, http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ko_29_11_agj_om_shq.pdf

⁶¹ Myzejene Selmani (Shefë e Grupit Parlamentar të KKR-së), intervistë në Prishtinë, 23 maj 2012.

⁶² Aleanca Kosova e Re, Statuti, neni 21

⁶³ Po aty, neni 23

⁶⁴ Po aty, neni 27

⁶⁵ Po aty, neni 30

⁶⁶ Po aty, neni 33

kishte hyrë në koalicion me disa parti tjera, duke rrezikuar kështu që të mos e kalonte pragun për të hyrë në Kuvendin e Kosovës. Votat për AKR kanë lëvizur kështu:

Viti i zgjedhjeve	2007	2010
Numri i votave	70165	(Si “Koalicioni për Kosovën e Re”) 50951

Kryetari i partisë, z.Behxhet Pacolli, është shprehur për mediat se është i zhgënjyer me jetën politike në Kosovë dhe ka shtuar se është duke e menduar që të tërhiqet krejtësisht nga jeta politike në vend. Për një parti ku motivi dhe ambiciet e liderit janë motori kryesor i angazhimit dhe veprimit, atëherë tërheqja madje edhe vetëm në mënyrë deklarative e liderit prek drejtpërdrejt substancën, kohezionin dhe proceset zhvillimore të saj.

3.6 Koalicioni VAKAT

Koalicioni VAKAT është koalicion i katër partive politike që përfaqësojnë komunitetin boshnjak në Kosovë: Demokratska Stranka Bošnjaka (Partia Demokratike Boshnjake), Demokratska Stranka Vatan (Partia Demokratike Vatan), Bošnjaka Stranka Kosova (Partia Boshnjake e Kosovës) si dhe Nova Demokratska Stranka (Partia Demokratike e Re). Koalicioni ekziston që gati një dekadë dhe mbulon gjeografikisht gati tërë komunitetin boshnjak në Kosovë.

Kryesuesi i koalicionit është z. Xhezair Murati. Bashkëpunimi në mes të anëtarëve të koalicionit është i mirë, sidomos mes tre anëtarëve të parë të koalicionit, DSB, DSV dhe BSK, dhe të gjitha vendimet merren në formë demokratike dhe me pajtimin e të gjithëve.⁶⁷ Mbledhjet e koalicionit janë të rregullta dhe mbahen çdo muaj. Koalicioni funksionon në bazë të marrëveshjeve të shkruara dhe gojore⁶⁸ ndërsa takohen rregullisht për të diskutuar çështjet që e preokupojnë komunitetin dhe koalicionin si dhe për të vendosur për qëndrimet që do të mbajë koalicioni në Kuvendin e Kosovës. VAKAT ka arritur të mbajë elektoratin e vet gjë që e tregon tabela më poshtë:

Viti i zgjedhjeve	2004	2007	2010
Numri i votave	4972	5428	5296

Partitë që përbëjnë koalicionin vazhdojnë të veprojnë si subjekte politike. DSB është partia më e madhe e koalicionit dhe selia e saj në Prizren shërben edhe si seli e koalicionit.

DSB ka Këshillin e Përgjithshëm dhe Këshillin Ekzekutiv si dhe Kryetarin e partisë. Kryetar i partisë është z.Nazim Demiri. Kryetari i deritashëm i partisë ishte z.Xhezair Murati, i cili kishte vendosur që të mos kandidohej më për postin e kryetarit të partisë që e kishte mbajtur me vite dhe që të lironte vendin për kuadro të reja. Partia është e rregullt në raportimet në KQZ. Forcë kohezive në parti është kapaciteti për të promovuar emancipimin e të drejtave të

⁶⁷ Intervistë e KIPRED me z.Xhezair Murati, intervistë në Prizren, 29.05.2012.

⁶⁸ Intervistë e KIPRED me z.Xhezair Murati, intervistë në Prizren, 29.05.2012.

komunitetit. Znj.Duda Balje nga DSB shprehet se partia ka konkurrencë nga partitë tjera dhe prandaj sfidë kryesore mbetet ruajtja e anëtarëve dhe elektoratit dhe atë duke u angazhuar për përfaqësim sa më të mirë të komunitetit⁶⁹.

Koalicioni VAKAT nuk është përfaqësuesi i vetëm i komunitetit boshnjak në Kosovë dhe autoriteti i koalicionit sfidohet nga parti tjera që nuk janë pjesë e koalicionit. Megjithatë, përparësi e koalicionit është shtrirja gjeografike dhe përfaqësimi i gati të gjitha komuniteteve boshnjake në Kosovë (përveç atyre nga veriu i Kosovës). Por, kjo shtrirje gjeografike krijon edhe një asimetri në përfaqësim dhe vendimmarrje brenda koalicionit pasi partitë që vijnë nga pjesët ku ka më shumë elektorat bëhen më të fuqishme. Këto parti njëherë kanë edhe më shumë mundësi që të gjejnë kuadro për partinë dhe të shtojnë kapacitetet e partisë për të zhvilluar demokraci të brendshme.

3.7 Partia e Pavarur Liberale – SLS

Samostalna Liberalna Stranka (SLS) është aktualisht partia më e madhe që përfaqëson komunitetin serb në Kosovë dhe që vepron në kuadër të sistemit politike e shtetëror të Kosovës. SLS është themeluar më 18 prill të vitit 2006 në Graçanicë. Ndonëse është themeluar që 6 vite, partia ende është në fazë të rritjes dhe shtrirjes gjeografike në tërë territorin e Kosovës. Kjo shtrirje jo e barabartë ka krijuar një asimetri edhe në proceset e vendimmarrjes dhe debatit brenda partisë. Përfaqësuesit nga Graçanica apo pjesa qendrore e Kosovës, që janë themelues të partisë, ende janë më të fuqishëm në vendimmarrje. Me shtrirjen e SLS në pjesët tjera të Kosovës, si në Shtërpcë por edhe në komunat e reja të themeluara, ky “sundim” i Graçanicës është sfiduar. Edhe brenda vet themeluesve të partisë thuhet të ketë përçarje dhe “sundimi” i grupit të Graçanicës nuk është aq hegjemon sa mund të duhet në shikim të parë.

Partia është e përqendruar në zonat ku ka komunitet serb, përveç pjesës veriore të Kosovës. Partia aktualisht është duke shtrirë prezencën e saj në Anamoravë dhe shtrirja e infrastrukturës partiake mbetet ndër sfidat kryesore të partisë.⁷⁰

Vendimmarrja në SLS nuk dallon shumë nga partitë tjera. Në përgjithësi tentohet të respektohen dokumentet si statuti i partisë. Madje SLS ka themeluar edhe institucionin *Gjyqi i Nderit* roli i të cilit është të bëjë vlerësimin e respektimit të statutit dhe veprimeve që mund të bien ndesh me nderin e partisë. Organi kryesor vendimmarrës është Kuvendi i partisë. Në mes dy Kuvendeve të partisë organ vendimmarrës është Këshilli Qendror që emërohet nga Kuvendi. Partia ka edhe Kryesinë që zbaton vendimet e Këshillit Qendror si dhe Kryetarin dhe nën-kryetarët.

Koordinimi mes partisë dhe Grupit Parlamentar është i mirë pasi edhe ashtu deputetët në Kuvend të Kosovës janë edhe anëtarë të Këshillit Qendror – organ i cili merr vendimet. Vota e fshehtë zbatohet kur votohet për Kryetar dhe nën-kryetarët por jo edhe në rastet tjera pasi aspirohet që për vendimet e partisë të arrihet konsensus.

⁶⁹ Duda Balje, intervistë në Prizren, 29 maj 2012.

⁷⁰ Petar Miletiq (Sekretar i Përgjithshëm i SLS), intervistë në Prishtinë, 14 qershor 2012.

Forcë kohezive e partisë, në rend të parë, është angazhimi për të drejtat e komunitetit. Përfaqësuesit e partisë besojnë se dëshmuar se ideja për pjesëmarrje në institucionet e Kosovës ishte e drejtë dhe se sukseset që ka arritur partia në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit serb dhe përmirësimin e kushteve për jetë në dikasteret e ndryshme brenda qeverisë, ka shtuar besimin e elektoratit.⁷¹ Rrjedhimisht, zyrtarët e partisë që kanë arritur të bëhen Kryetar Komune, si në Graçanicë e në Shtërpçë, kanë fituar fuqi politike dhe brenda partisë. Rritja e përkrahjes për SLS dëshmohet nga numri i votave që ka marrë në vitin 2010 në krahasim me vitin 2007 kur për herë të parë SLS ka marrë pjesë në zgjedhje:

Viti i zgjedhjeve	2007	2010
Numri i votave	855	14352

Sfidë për partinë mbetet shtrirja gjeografike dhe ngritja e kapaciteteve. SLS nuk vepron në pjesën veriore të Kosovës ndërsa në pjesën lindore – në Anamoravë – vetëm tani ka filluar të shtrijë prezencën e saj. Zgjerimi i partisë kërkon edhe shtim të kuadrove dhe kapaciteteve partiake.

3.8 Partia Demokratike Turke e Kosovës – KDTP

Partia Demokratike Turke e Kosovës është themeluar në vitin 1990 dhe në 12 vitet e fundit kryetar i saj është z.Mahir Yağcılar. KDTP është e vetmja parti që përfaqëson komunitetin turk në Kosovë. Ndonëse ka pasur nisma jashtë partisë për krijimin e subjekteve të reja, ato janë shuar brenda një kohe të shkurtër. Forca kohezive në këtë parti është avancimi dhe mbrojtja e interesave të komunitetit turk, veçanërisht gjuhës dhe fesë e cila konsiderohet të jetë faktori kryesor që mbanë të bashkuar këtë komunitet.

Sipas statutit të KDTP-së, Kuvendi është organi më i lartë i partisë. Kuvendi përbëhet nga 81 delegatë të emëruar nga kuvendet e degëve.⁷² Kuvendi zgjedh 27 anëtarë të tjerë për Këshillin Qendror Drejtues i cili është organ politik ekzekutiv.⁷³ Ky këshill ka fuqi ekzekutive në hartimin e programit politik, statutit dhe rregullave tjera të brendshme dhe marrjen e vendimeve rreth koalicioneve qeveritare. Këshilli Qendror mblidhet së paku një herë brenda dy muajve dhe kryesohet nga kryetari i partisë i cili në të njëjtën kohë është edhe kryesues i të gjitha organeve tjera në parti. Çështjet operative në parti janë kompetencë e Këshillit Kryesues i cili duhet të mblidhet së paku një herë në dy javë. Këshilli Kryesues përbëhet nga: Kryetari i partisë, zëvendëskryetarët e partisë, ministrat, deputetët dhe kryetarët e degëve, ndërsa vendimet merren me shumicë votash të të pranishmëve.⁷⁴ Përkrahja e elektoratit për partinë ka mbetur në përgjithësi konstante, siç tregon edhe tabela më poshtë:

Viti i zgjedhjeve	2001	2004	2007	2010
Numri i votave	7879	8353	4999	8548

⁷¹ Petar Miletiq (Sekretar i Përgjithshëm i SLS), intervistë në Prishtinë, 14 qershor 2012.

⁷² Partia Demokratike Turke e Kosovës, Statuti, neni 22

⁷³ Po aty, neni 34

⁷⁴ Po aty, neni 36

Për të siguruar një përfaqësim sa më të madh në Kuvendin e Kosovës, komunitetit turk ka tentuar në vazhdimësi t'i shmanget krijimit të subjekteve të reja politike, edhe pse ndasitë e herë pas herë brenda KDTP-së kanë ngacmuar ambiciet politike të grupeve të ndryshme për t'i hyrë garës elektorale. Në vitet e 90-ta që krijuar edhe Partia Popullore Turke por ajo nuk kishte gjetur mbështetjen e bazës. Deri sa ndasitë e viteve të mëhershme kanë qenë më shumë për arsye ideologjike, këto të fundit brenda KDTP-së në shumicën e rasteve janë për pozitën e të parit të partisë. Brenda kësaj partie është zhvilluar një frymë e fuqishme opozitare e cila konteston veprimet e kryetarit të saj z.Mahir Yağcılar. Miratimi i statutit të ri të partisë më 5 gusht 2011, nga grupi opozitar brenda KDTP-së konsiderohet të jetë bërë nëpërmjet rrugëve jo formale, madje duke mos i ftuar të gjithë delegatët e Kuvendit.⁷⁵ Këtë e pohon edhe vet kryetari i KDTP-së, me arsyetimin se “disa probleme duhet tejkaluar pa krijuar probleme të tjera”.⁷⁶ Disa nga delegatët të cilët nuk kanë marr pjesë në këtë Kuvend i janë drejtuar KQZ-së me një ankesë në të cilën pretendojnë që statuti është ndryshuar me procedurë jo të rregullt dhe fuqizon postin e kryetarit. KQZ, përkatësisht Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, në përgjigjen e saj konsideron se nuk ka shkelje të theksuar lidhur me procedurat e thirrjes, mbajtjes së Kuvendit dhe ndryshimplotësimeve në statutin e KDTP-së.⁷⁷ KQZ e cila kishte prolonguar çështjen duke mos saktësuar përgjigjen e saj, ka kontribuar edhe më shumë në acarimin e marrëdhënieve brenda partisë.

KIPRED ka zbuluar se më herët Zyra kishte përgatitur një përgjigje me të cilën i cilëson si të parregullta e rrjedhimisht edhe të papranueshme ndryshimet e bëra në Statut. Kjo Përgjigje asnjëherë nuk i është dorëzuar zyrtarisht palës që është ankuar dhe ka kërkuar përgjigje. KIPRED ka mësuar se ndryshimet në përgjigje janë bërë për shkak të ndikimeve politike në Zyre.

Raportimet financiare të KDTP-së pranë KQZ-së janë të rregullta por kjo nuk mund të thuhet kur është fjala për raportimet në parti. Ka tre vite që nuk është raportuar për financat dhe aktivitetet e partisë. Madje z.Organ Lopar thotë se “kryetari i partisë menaxhon me të gjitha mjetet financiare dhe ne nuk kemi fare njohuri se si po menaxhohen ato”.⁷⁸

KDTP në Kuvendin e Kosovës është e përfaqësuar me tre deputet të cilët mbajnë poste udhëheqëse si pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, kryesojnë Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe mban katër poste të nënkryetarëve. KDTP gjithashtu është pjesë e koalicionit qeverisës dhe udhëheq me Ministrinë e Administratës Publike. Deputetët e KDTP-së në vazhdimësi komunikojnë me kryesinë por edhe me komisionet e veçanta brenda partisë me të cilët konsultohen për marrjen e vendimeve në Kuvend. Ndërsa për çështje të rëndësishme vendimet i merr partia.⁷⁹ Puna e deputetëve monitorohet kryesisht nga Kryesia e partisë përmes raportimeve të deputetëve. KDTP mohon të ketë ndikime nga mekanizmat

⁷⁵ Sipas procesverbalit të Kuvendit, nga 64 delegatë të pranishëm kanë qenë 34

⁷⁶ Mahir Yağcılar (kryetar i KDTP-së), intervistë në Prishtinë, 30 maj 2012

⁷⁷ Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, përgjigja në kërkesën për shqyrtimin e shkeljeve në ndryshim-plotësimin e statutit të KDTP-së, në Kuvendin e mbajtur me 5 gusht 2011.

⁷⁸ Orhan Lopar (Nënkryetar i Komunës së Prizrenit për komunitete), intervistë në Prizren, 29 maj 2012

⁷⁹ Enis Kervan (Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e KDTP-së), intervistë në Prishtinë, 28 maj 2012.

ndërkombëtar në marrjen e vendimeve. Zyrtarët e partisë e çmojnë rolin e ambasadës Turke në Kosovë që e konsiderojnë rol këshillëdhënës e jo ndërhyrje.⁸⁰

⁸⁰ Mahir Yağcılar (kryetar i KDTP-së) intervistë në Prishtinë, 30 maj 2012.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

4.1 Nevoja për reformim

Shumica e partive politike të intervistuar nuk e kontestojnë nevojën për reformim të brendshëm. Zgjedhjet e vitit 2010 u karakterizuan me manipulimet më të mëdha të bëra ndonjëherë përgjatë periudhës relativisht të shkurtër të zgjedhjeve të organizuara deri më tani. Manipulime me vota u bënë edhe brenda vet listave të partive pasi kandidatë të partisë nxituan të siguronin një vend për vete në Kuvendin e Kosovës e me këtë edhe autoritet më të lartë në parti e madje edhe për të gëzuar imunitetin e deputetit para ligjit.

Zgjedhjet për Kryetar Komune të mbajtura në pranverën e vitit 2012 janë përvoja krejtësisht tjera nga zgjedhjet e vitit 2012, si në rastin e Ferizajit ashtu edhe në rastin e Kaçanikut. Raportimet për keqpërdorime janë minimale ndërsa KQZ-ja i ka shpallur zgjedhjet e rregullta dhe të pranueshme. Partitë politike i kanë pranuar rezultatet dhe nuk i kanë kontestuar.

Është e rëndësishme që të shfrytëzohet ky momentum dhe të inkurajohen partitë që të vazhdojnë në reformat e brendshme dhe në vënien e parimeve të demokracisë si parime udhëheqëse të partisë.

Reformës mund t'i kontribuojë edhe zbehja relative e rolit të liderit të partisë. Në PDK, si partia më e madhe, zyrtarë të lartë të partisë e kanë sfiduar hapur kryetarin e partisë duke paralajmëruar një garë të hapur në zgjedhjet partiake që pritet të mbahen. LDK tanimë ka eksperiencë me ndërrimin e kryetarit të partisë në një garë të hapur dhe të drejtë. AAK është në një pozitë më të vështirë pasi lideri i saj nuk lejohet të jetë aktiv në jetën politike pasi pret vendimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi lidhur me akuzat për krime lufte. LVV është subjekt i ri politik që identifikohet fuqishëm me liderin dhe ende nuk ka arritur pikën kur do të sfidohet lideri njësoj si edhe AKR që është themeluar rreth personalitetit të liderit dhe mbetet e varur nga lideri. Në SLS si dhe në koalicionin VAKAT lideri gjithashtu nuk "sundon" i pa sfiduar. Vetëm KDTP paraqet një kthim prapa në këtë rast pasi atje pas një praktike të ndryshimit të liderit me proces të brendshëm demokratik, partia tani përballet me forcimin e postit të liderit dhe centralizimin e fuqisë partiake në duart e tij.

Ky raport ka zbuluar se në partitë politike në Kosovë ka shumë mangësi në funksionimin demokratik të brendshëm. Zhvillimi i demokracisë brenda subjekteve politike është qenësor për zhvillimin e përgjithshëm të demokracisë në vend. Prandaj, mbetet imperativ që të zhvillohet demokracia brenda partive. Është konfirmuar se metodat joformale të vendimmarrjes janë ende të fuqishme brenda partive politike duke përjashtuar organet e partisë nga ky proces; financimi i partisë është jo-transparent gjë që jep shkas për të dyshime për rrugët e financimit; liderët ende janë në gjendje të ushtrojnë kontroll në parti dhe të ndikojnë në vendimmarrje; mekanizmat ndërkombëtarë janë në pozitë që nëpërmjet ndikimit mbi liderin të ndikojnë edhe në vendimet e partisë madje edhe kur kjo është në dëm të debatit dhe demokracisë brenda subjektit. Këto praktika duhet të eliminohen nga partitë politike për t'i hapur rrugë funksionimit të partisë me metoda të hapura, demokratike e transparente.

4.2 Rekomandimet

Për të fuqizuar demokracinë brenda partive politike në Kosovë dhe për të eliminuar praktikën që ngufasin zhvillimin e partive e rrjedhimisht edhe të demokracisë në Kosovë, KIPRED, në bazë të gjetjeve të këtij raporti, jep këto rekomandime:

- Të përmirësohet korniza ligjore e funksionimit të partive politike. Duhet të ketë ligj të veçantë për regjistrim dhe funksionim të partive politike. Rregullorja e tanishme nuk mjafton që të garantohet një funksionim i përgjegjshëm i partive politike në Kosovë.
- Të fuqizohen ligjet që kanë të bëjnë me financimin e partive politike. Partitë politike në Kosovë nuk janë të sigërtë në raportimin e të hyrave dhe shpenzimeve të tyre. Kjo lë hapësirë për dyshime se partitë politike financohen nga burime të dyshimta. Kjo dëmton imazhin e partive si dhe dekurajon votuesit që të marrin pjesë në votime.
- Të rregullohet çështja e auditimit të partive politike që të sigurohet mbikëqyrje dhe transparencë e shpenzimeve të partive. Auditimi duhet të bëhet nga kompani të pavarura. Kjo do të shtojë besimin e elektoratit në partitë politike e rrjedhimisht edhe në sistemin elektorale dhe demokracinë politike në Kosovë.
- Fondi për Demokratizim të Partive Politike që ndahet nga buxheti i Kosovës të kthehet nën menaxhimin e Kuvendit të Kosovës. Të vihen kushte rigorozë të shpenzimit të këtij fondi ashtu që këto shuma të shfrytëzohet për ngritje të kapaciteteve demokratike të partive e jo për pagesë gjobash apo praktika të ngjashme.
- Të fuqizohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim. Mungesa e kapaciteteve për të kryer punën e vet e Zyrës krijon hapësirë për shkelje dhe mos-respektim të statutit e rregullave gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngecjen e reformave demokratike brenda partive politike. Duhet të shtohet personeli i Zyrës ashtu që të jetë në gjendje të përcjellë hollësisht veprimtarinë e të gjitha subjekteve politike. Zyra gjithashtu duhet të lirohet nga presionet e politikës dhe të jetë në gjendje të marrë vendime në mënyrë të pavarur.
- Statutet e partive politike duhet të azhurnohen dhe të korrigjohen. Duhet të futen provizionet që garantojnë votim të fshehtë dhe kandidim të më shumë kandidatëve. Statuti duhet të garantojë që partia do të funksionojë edhe në rastet kur ajo e merr pushtetin.
- Partitë politike duhet të garantojnë respektimin e Statutit dhe procedurave për vendimmarrje. Praktikën e marrjes së vendimeve me rrugë joformale duhet të eliminohen nga jeta e partive politike. Anëtarësia e partive politike të kërkojë nga partia që të respektojë dokumentet e veta dhe parimet e garës së hapur dhe të drejtë për postet partiake.